

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations Unies
au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO**

**TRANSKRIPTI
I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS, TË MBAJTUR
MË 15 QERSHOR 2006**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA,
ODRŽANE 15 JUNA 2006 GOD.**

QERSHOR – JUNI 2006

R E N D I I D I TË S

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme;
3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit civil kundër shpifjes dhe fyerjes;
4. Shqyrtim i dytë i Projektligjit për veprimtaritë hidrometeorologjike;
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për eficencën e energjisë;
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin e Ligjit nr.2004/12 për standardizim;
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për raportimet financiare të ndërmarrjeve;
8. Përgjigjja e kryeministrit për interpelancë lidhur me Ligjin për vlerat e luftës së UÇK-së;
9. Shqyrtimi i propozimit për emërimin e anëtarit të pestë të Këshillit të KPM;
10. Shqyrtimi i propozimit për caktimin e kushteve dhe të kritereve për zgjedhjen e Avokatit të Popullit të Kosovës;
11. Pyetja e deputetit Ferid Agani për ministrin e Ekonomisë dhe të Financave.

DNEVNI RED

1. Usvajanje dnevnog reda;
2. Usvajanje zapisnika sa prethodne sednice;
3. Drugo razmatranje Nacrta zakona protiv klevete i uvrede;
4. Drugo razmatranje Nacrta zakona o hidrometereološkoj delatnosti;
5. Drugo razmatranje Nacrta zakona o efikasnosti energije;
6. Prvo razmatranje Nacrta zakona o izmeni Zakona br. 2004/12 o standardizaciji;
7. Prvo razmatranje Nacra zakona o finansijskom izveštavanju preduzeća;
8. Odgovor premijera na interpelaciji u vezi sa Zakonom o vrednostima rata OVK-a;
9. Razmatranje predloga o imenovanju petog člana Saveta NKM;
10. Razmatranje predloga za utvrđivanje uslova i kriterija za izbor Ombudsmana Kosova;
11. Poslaničko pitanje Ferida Aganija za ministra za privredu i financije

Seanca u mbajt në sallën e Kuvendit të Kosovës dhe filloi në orën 10,00

**Seancën e drejtoi: Kolë Berisha, kryetar i Kuvendit
Bashkëkryesues: Sabri Hamiti**

KRYESUESI SABRI HAMITI - Kolegë deputetë të nderuar, anëtarë të Qeverisë së Kosovës, ju shpreh mirëseardhje në këtë seancë të Kuvendit të Kosovës. Ju e keni marrë një propozim të rendit të ditës së seancës së sotme.

Që në fillim ju njoftoj se kryetari nuk do të jetë me ne, sepse ka një takim të rëndësishëm, por do të na bashkohet më vonë. Në anën tjetër kam një informatë që rrëth orës 15,00 Kuvendit sot do t'i drejtohet kryeministri i Shqipërisë, z. Sali Berisha dhe një korrigjim të pikës 11 të rendit të ditës, ku është një pyetje e deputetit Ferid Aganit për ministrin e Ekonomisë. Ju njoftoj se këtu nuk është vetëm një pyetje, por do të janë disa pyetje dhe kjo do ta ketë formulimin: Pyetje për Qeverinë e Kosovës.

A ka dikush të thotë diçka për rendin e ditës.

Fjalën e ka deputeti Ibush Jonuzi.

DEPUTETI IBUSH JONUZI – Faleminderit z. kryesues, ministra të nderuar, deputetë të respektuar, do të them diçka rrëth pikës së 5- të rendit të ditës. Projektligi për efikacën e energjisë. Komisioni funksional ka punuar në këtë çështje për amendamentimin e ligjit në fjalë, por meqë disa çështje edhe më tutje duhet të harmonizohen me Ministrinë përkatëse, i propozoj Kuvendit që kjo pikë e rendit të ditës të hiqet nga seanca e sotme. Ju faleminderit.

KRYESUESI SABRI HAMITI - Kush është që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për një seancë tjetër për shkak të konsultimeve plotësuese?

Numëroni votat. Fjalën e ka z. Gani Koci

DEPUTETI GANI KOçi – Unë e marr fjalën kur kam të them diçka dhe kur kam fjalë. Z. kryesues Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës kundërshton propozimin për heqjen nga rendi i ditës të Projektligjit për efikacën e energjisë elektrike. Arsyet janë këto. Në shqyrtimin e parë të këtij projektligji ka pasur vërejtje lidhur me këtë projektligj për të cilin kemi votuar, pastaj nga shumica e Kuvendit, prandaj duke pasur parasysh se ne kemi pasur vërejtje për këtë projektligji, shumë herë, s'ka qenë nevoja të nxirrej fare si projektligj, meqë është miratuar në parim nga Grupi Parlamentar dhe nga shumica e Kuvendit. Ku janë arsyet që të mos jetë në rendin e ditës?

KRYESUESI SABRI HAMITI – Ne e dëgjuam deputetin Koci, asgjë nuk ke sqaruar z. Koci, unë po them edhe një herë jam i detyruar me rregullore ta hedh në votim propozimin e Jonuzit. Kush është që të hiqet sot nga rendi i ditës?

Kush është kundër që të hiqet. A abstenon dikush.

E kemi këtë rezultat:

Për45 votues që të hiqet nga rendi i ditës Projektligji
Kundër25
Abstenim 3

Konstatoj se kjo pikë hiqet nga rendi i ditës.

Fjalën e ka kërkuar Emrush Xhemajli

DEPUTETI EMRUSH XHEMAJLI - Inderuari kryesues, pjesëmarrës të seancës. Kjo që po e them ndoshta hyn në kuadër të procedurës. Unë kërkoj ta bëjmë një pauzë deri sa të lironen të burgosurit politikë, në mesin e të cilëve edhe veprimtarët Albin Kurti, Naim Zhitia dhe Liburn Aliu. Sot një javë SHPK-ja ka sulmuar natën dhe i ka arrestuar gjatë 8 shtatorit në Prishtinë 81 demonstrues paqësorë, disa prej tyre duke i bërë për spital, ata ende po mbahen në burg, ata u lënduan gjatë arrestimit, u provokuan duke u ofruar produkte të Serbisë për çka ata janë hedhur në grevë, mbi të gjitha u fye dinjiteti i tyre duke i quajtur si armiq të pavarësisë së Kosovës. Këto janë shkelje elementare e të drejtave të qytetarëve, për shkak të shkeljes të të drejtave për të protestuar

KRYESUESI SABRI HAMITI – Jemi në rend dite z. Xhemajli, kështu është e strukturuar kjo dhe nuk është e imja kjo. A ke propozim, se nuk ke kohë më tepër. Alush Gashi e ka kërkuar fjalën.

DEPUTETI ALUSH GASHI – Inderuari z. kryesues. Në pikën 9 të rendit të ditës është paraparë propozimi për anëtarë të Komisionit të Pavarur për Media. Neve deri në këto momente nuk na ka ardhur asnjë biografi, asnjë propozim. Andaj kërkojmë që kjo ose të sqarohet në fillim ose të hiqet nga rendi i ditës, sepse është një pikë për të cilën kjo seancë është e përgatitur. Nuk kemi kandidat, nuk kemi biografi të propozuar nga individi as dokument –propozim nga Kryesia e Kuvendit për Komisionin e Pavarur për Media. Ju faleminderit.

KRYESUESI SABRI HAMITI – Kam një sqarim të vogël. Ne e kemi një propozim të Kryesisë që është bërë si propozim me pëlgim të plotë dhe në rend të ditës ka hyrë, duke pasur parasysh atë propozim të cilin e ka bërë Kryesia me pëlgim të plotë. Në ndërkokë ne kemi kontaktuar, siç kontaktohet me rregulla, por duket se mund të ketë atë që quhet konflikt interesash. Unë megjithatë mendoj që pika e rendit të ditës mund të mos fshihet tash, në mënyrë që të kemi shansin ndoshta për sqarim dhe për marrëveshje gjatë kohës së seancës, sot ose nesër, sido që të jetë, ju e keni propozimin që e dha z. Alush Gashi. Kush është që të hiqet nga rendi i ditës kjo.

Fjalën e kërkoni z. Fehmi Mujota

DEPUTETI FEHMI MUJOTA – Faleminderit z. kryesues. Pikërisht në vijë të propozimit të z. Alush Gashi qëndron edhe propozimi i Partisë Demokratike të Kosovës, meqë të thuhet shqyrtimi i propozimit për emërimin e anëtarit të pestë të të Komisionit të Pavarur për Media, nënkupton që në mënyrë të hapur Kuvendi duhet ta zgjedhë këtë

person, duhet të ketë biografinë e tij dhe duhet të jetë në përputhje me Ligjin e Pavarur të Mediave ,në të cilin është precizuar shumë saktë në pikën 4.7 a, b, c, d, e, f, që duhet të plotësojë disa kritere për të qenë i propozuar një kandidat, prandaj jemi për shtyrje të pikës së rendit të ditës për mbledhjen tjetër.

KRYESUESI SABRI HAMITI – A ka dikush të shtojë për këtë pikë?

Kush është kundër?

Për53 votojnë të shtyhet kjo pikë e rendit të ditës.

Fjalën e ka kërkuar Naxhije Doçi.

DEPUTETJA NAXHIJE DOÇI – Faleminderit z. kryesues, të nderuar ministra, kolegë deputetë. Unë e kam një vërejtje për pikën e dytë të rendit të ditës, te procesverbali, sepse në mbledhjen e kaluar në marrëveshje me Kryesinë e Parlamentit dhe me teknikën e kamë dorëzuar punimin tim lidhur me vlerësimin e Projektligjit në lexim të parë, Ligjin për lëndën arkivore.

KRYESUESI SABRI HAMITI – Z. Doçi ne nuk jemi ende në atë pikë, ne po bisedojmë për rendin e ditës, kur të vijë procesverbali ta jap fjalën.

DEPUTETJA NAXHIJE DOÇI – Unë mendova se thatë a pajtoheni me pikat e rendit të ditës, ashtu thatë në fillim z. kryesues.

KRYESUESI SABRI HAMITI – Fjalën e ka kërkuar Jakup Krasniqi.

DEPUTETI JAKUP KRASNIQI - Z. kryesues. Para dy seancave ose më saktë kur kemi biseduar për çështjen e Universitetit, kërkesa me 42 nënshkrime ka qenë të debatohej për arsimin në përgjithësi. Në atë seancë ky debat është shtyrë dhe ka mbetur vetëm çështja e Universitetit, për të cilin është debatuar. Arsimi ka mbetur për mbledhjet e ardhshme që të hyjë në rend të ditës, por kjo është seanca e dytë që mbahet dhe arsimi nuk duket se do të jetë temë debati në seancë. Mendoj se Kryesia ka pasur për obligim, çështjen e arsimit ta radhiste në këtë seancë në rend të ditës. Pse nuk ka hyrë? Unë në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së kërkoj sqarim, pse çështja e arsimit në dy seanca nuk futet në rend të ditës.

KRYESUESI SABRI HAMITI – Sqarimin do t'ia përcjell Kryesisë. Fjalën e ka kërkuar Xhavit Haliti .

DEPUTETI XHAVIT HALITI - Z. kryesues, me qenë se kaloi ajo pjesë për të cilën u votua, unë kam vetëm një kërkesë dhe një problem që ta ngris në Parlamentin e Kosovës lidhur me propozimet që po bëhen, qoftë për bordin e mediave, qoftë për të gjitha të tjera, në veçanti për Komisionin e Pavarur të Mediave. Unë mendoj që ne do të duhej të uleshim si pozitë dhe opozitë së pari dhe ta trajtojmë këtë problem. Nuk është njësoj sikur ta sjellim një kandidat në Kuvend dhe të votojmë për , kushto qoftë ai ,që do ta propozojë , Kryesia ose kushdo tjetër ,sepse ajo nuk më duket aspak demokratike. Unë mendoj që, veçanërisht për këtë komision .që i ka të bëjë për të ardhmen e mediumeve, për të ardhmen e Radiotelevizionit si televizion publik dhe që me anë të këtij komisioni

do të emërohen me siguri edhe drejtori i Televizionit edhe sekretari i tij dhe do të zgjidhen shumë çështje sende që kanë të bëjnë me mediumet. Ne do të kemi edhe zgjedhje, do të kemi edhe promovime të tjera publike, qoftë të partive qoftë të pozitës dhe të opozitës. Unë konsideroj që po të bëhet si me qëllim kjo punë qe sa herë vijnë propozimet e ndryshme, vijnë propozime nga institucioni. Këtu mendoj se do të duhej të ndërtohej, të nxirrej së pari rregullorja për miratimin e këtij komisioni, për mënyrën e caktimit dhe miratimit të anëtarëve të këtij komisioni. Vërtetë pozita dhe opozita që të janë të përfaqësuar në mënyrë të barabartë në kuadër të këtij Komisioni, për ndryshe në qoftë se veprohet kështu, ndoshta sot dikush është pozitë dhe nesër mund të bëhet dikush tjetër pozitë gjithmonë mediumi kryesor, Radiotelevizioni i Kosovës, do të mbetet instrument ose celulë në duar të pozitës. që do t' mbrojë interesat vetëm të pozitës. Propozoj të ketë balanc politik ndërmjet pozitës dhe opozitës në këtë komision dhe të votohet me alternativë në Parlament. Unë nuk e kuptoj pse të votohet kur propozohet vetëm një alternativë.

KRYESUESI SABRI HAMITI – Z. Haliti idenë tënde e morëm në dijeni, atë temë sot e hoqëm nga rendi i ditës. Janë instancat edhe në Kryesi ku je anëtar edhe në Parlament dhe në komisione dhe propozoni të gjitha modalitetet si propozohet, si thotë shumica ashtu do ta bëjmë.

Fjalën e ka kérkuar Bajrush Xhemajli .

DEPUTETI BAJRUSH XHEMAJLI – Faleminderit z. kryesues dhe sigurisht që do t'i kryesosh edhe shumë herë mbledhjet e Kuvendit, prandaj unë e kam një vërejtje. Tash kaloi arsyja pse e kisha vërejtjen, por me gjithatë mund të përsëritet, tensioni që u ngrit lidhur me marrjen e fjalës, mendoj se nuk është mirë të përsëritet, për faktin se të gjithë deputetët, qoftë të LDK-së, të PDK-së dhe të tjerët, janë të barabartë sipas Rregullores dhe duhet t'u jepet fjalë atëherë kur e kérkojnë. Natyrish se tensioni u ngrit nga ju e jo nga ngritja e zërit të kolegut tim. Unë jam nënkyetar i Komisionit dhe kam kérkuar për efiqencë fillimi fjalën që edhe më ka takuar ta marr, por nuk ma keni dhënë. Unë ju përkrah, por është mirë të shikohet në këtë drejtim. Ju faleminderit.

KRYESUESI SABRI HAMITI – Shikoni, kanë të drejtë të flasin dhe ta kérkojnë fjalën deputetët, por ata janë aq të kulturuar dhe e dinë se nuk mund të flasin 5 deputetë përnjëherë, por flasin një nga një. Unë e kam një rend këtu dhe po e eksploroj dalngadal me emra. Fjalën e ka Bajrush Xhemajli.

DEPUTETI BAJRUSH XHEMAJLI – Po kérkoj replikë se nuk është mirë të keqpërdoret pozicioni që e keni, për faktin se nuk mund të kërkosh 10 menjëherë përmes monitorit këtu. Unë e kam kérkuar dhe një nga një kanë ardhur. Ju faleminderit.

KRYESUESI SABRI HAMITI – Një nga një se nuk mund të flasin të gjithë përnjëherë thashë, a po e duan edhe një herë fjalën, por po i përsëritni gjërat e kaluara. Fjalën e ka Hydajet Hyseni – Kaloshi.

DEPUTETI HYDAJET HYSENI – KALOSHI – Ju faleminderit z. kryesues. Më lejoni që në përputhje me rregullën 30e ,ta shpreh kundërshtimin tim për mënyrën si u zhvillua

procedura në rastin e propozimit të deputetit Emrush Xhemajli. Atij iu ndërpri fjala dhe nuk u shqyrtua as propozimi që bëri ai me arsyetimin se koha e paraparë për diskutim është 1 minutë. U tha edhe pak më parë se kjo është në rregull, por për mendimin tim është e gabuar, sepse rregulla 7 paragrafi i fundit thotë: Diskutimi lidhur me rendin e ditës nuk zgjat më shumë se 2 minuta. Mendoj se deputetit Emrush Xhemajli ia kemi borxh, si Kuvend t'i kërkojmë falje dhe ia shqyrtojmë propozimin, por e shfrytëzoj rastin të deklaroj se e mbështhes propozimin e z. Xhemajli.

KRYESUESI SABRI HAMITI – Ju lutem, zonja dhe zotérinj. Unë këto përkufizime teknike s'i kam bërë, këto i ka bërë Rregullorja e Kuvendit me ata që e bëjnë teknikën, edhe t'i i ke kaluar 2 minuta, por njeriu vetveten s'e mat sa i ka kaluar, ajo është teknikë automatike. Ju jeni deputetë, thuani se janë pak, ndërrrojeni dhe mos protestoni. Nëse rregulla është në fuqi do ta zbatojmë strikt. Fjalën e ka Nekibe Kelmendi.

DEPUTETJA NEKIBE KELMENDI – I nderuari kryesues, të gjithë jemi të njoftuar se në 3 komunat e Veriut të Kosovës është shpallur gjendje e jashtëzakonshme, por këtë gjendje të jashtëzakonshme nuk mund ta shpallin sipas Kornizës Kushtetuese, as sipas ndonjë dokumenti tjeter relevant, as në bazë të Rezolutës së cilës i referohen ata. Shpallja e gjendjes së jashtëzakonshme ka pretekstin e sjelljes së forcave të MUP-t dhe të krijimit të trazirave në atë pjesë të Kosovës, në momentin kur kemi arritur në procesin përfundimtar të finalizimit të statusit të Kosovës. Nga Kuvendi i Kosovës kërkoj që me një deklaratë të prononcohem i dhe ta dënojmë shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme në këtë pjesë të Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI SABRI HAMITI – Kemi një propozim që znj. Nekibe Kelmendi kërkon që Kuvendi i Kosovës të prononcohet lidhur me ndodhitë ose me informatat në komunat e Veriut të Kosovës, kërkoj prononcim të grupeve parlamentare. Z. Alush Gashi e ka fjalën.

DEPUTETI ALUSH GASHI – I nderuari z. kryesues. Ne si grup e kuptojmë shqetësimin e përgjithshëm të qytetarëve të Kosovës dhe konsiderojmë se kjo është çështje shumë e rëndësishme, andaj kërkojmë që në atë nivel të debatohet. Me znj. deputete në grupit tonë parlamentar do të bisedojmë, ashtu siç kemi biseduar sot edhe me kryetarin e Grupit Parlamentar të PDK-së, do të bisedojmë edhe me kryetarë të tjerë dhe me ju në Kryesi të Kuvendit të Kosovës. Do të shikojmë si zhvillohet procedura e informimit dhe e vendimit lidhur me këtë çështje. Ju faleminderit!

KRYESUESI SABRI HAMITI – Fjalën e ka z. Krasniqi, kryetar i Grupit Parlamentar të PDK-së.

DEPUTETI JAKUP KRASNIQI – Z. kryesues, nëse me këtë çështje duhet të merret Parlamenti nuk jemi kundër kësaj, por unë kërkoj pauzë që shefat e grupeve parlamentare të diskutojnë për këtë çështje përfaktin se kjo është një çështje e ndjeshme dhe mendoj se është edhe e ngutshme, prandaj duhet -si shefa të grupeve- të bisedojmë

për mënyrën se si do ta debatohet dhe a do të jetë kjo çështje sot në rend të ditës apo jo. Propozoj një pauzë që ne shefat e grupeve të merremi vesh.

KRYESUESI SABRI HAMITI – Fjalën e ka kërkuar deputeti Maloku.

DEPUTETI NAIM MALOKU – Ju faleminderit z. kryesues. Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së e përkrah shqetësimin e shprehur nga znj. deputete Kelmendi, e përkrahur nga Grupi Parlamentar i LDK-së dhe tash edhe i PDK-së. Mendojmë se kjo çështje nuk mund të debatohet sot përfaktin se përtë hyrë në rend dite kjo duhet të kërkojmë si Kuvend informacione çfarë masash janë marrë nga policia e UNMIK-ut, çfarë masa janë marrë nga KFOR-i, Ministria e Punëve të Brendshme e Kosovës, Ministria e Pushtetit Lokal dhe nga Ministria e Drejtësisë, pra t'i shohim të gjitha segmentet veç e veç si funksionojnë në ato pjesë, d.m.th. përt'u debatuar në lidhje me këtë çështje në Kuvend të Kosovës, duhet një informatë i gjithanshme, në të gjitha sferat dhe normalisht mendojmë se kjo është e nevojshme, por përsot nuk mund të shtrohet. Ju faleminderit!

KRYESUESI SABRI HAMITI – Ju faleminderit z. Maloku. Fjalën e ka kërkuar znj. Teuta Sahatqija, shefe e Grupit Parlamentar të Orës.

DEPUTETJA TEUTA SAHATQIJA – Faleminderit z. kryesues. Pajtohem me deputeten Kelmendi që situata në Veri të Kosovës është e nderë dhe duke i pasur parasysh situatën në të cilën Kosova gjendet tash dhe procesin e negociatave, mendoj se kjo gjendje mund të kualifikohet si çështje emergjente, përtë cilën Parlamenti duhet të diskutojë, por gjithsesi pajtohem edhe me kolegut tim Jakup Krasniqi që përkëtë çështje të bëhet një pauzë që shefat e grupeve parlamentare të diskutojnë dhe të marrin qëndrim se në çfarë mënyre do të diskutohet, a do të shtrohet si çështje dhe në ç' mënyrë do të bisedohet përtë, pasi situata është emergjente dhe e meriton një pauzë që të bisedojmë dhe të marrim qëndrim. Ju faleminderit!

KRYESUESI SABRI HAMITI – Z. Teuta ju faleminderit. Fjalën e ka kërkuar deputeti Ferid Agani.

DEPUTETI FERID AGANI – Edhe unë në emër të Grupit Parlamentar për Integrin e përkrah kërkesën e parashtruar nga shefi i Grupit Parlamentar të PDK-së përs një pauzë dhe përs një takim të shefave të grupeve parlamentare, sepse situata me të vërtetë është përbrengosje dhe me siguri që një takim i shefave të grupeve parlamentare, në të cilën do të merrej një vendim të kërkohet informatë urgjente nga Qeveria e Kosovës në lidhje me gjendjen e krijuar dhe të mbahet një seancë e jashtëzakonshme e Kuvendit të Kosovës. Mendoj se do të ishte propozim që Kuvendi sot do të duhej ta miratonte. Ju faleminderit!

KRYESUESI SABRI HAMITI – Faleminderit z. Agani. Fjalën e ka Xhezair Murati.

POSLANIK DŽEZAIR MURATI – Parlamentarna grupa 6+ se pridružuje zahtevu da se napravi pauza i da šefovi grupa zauzmu stav povodom ovog pitanja, mi se pridružujemo

ovim zahtevima smatrujući o važnim pitanjima i vrlo je bitno da se uzme zajednički stav. Dakle mi podržavamo da se napravi pauza i zauzme stav povodom ovog pitanja kako bi smo bili jedinstveni. Hvala.

KRYESUESI SABRI HAMITI – Faleminderit z. Murati. Fjalën e ka kërkuar deputeti Sabit Rahmani.

DEPUTETI SABIT RRAHMANI – Ju faleminderit z. kryesues, desha ta njoftoja Kuvendin se ndoshta nuk e di që një pjesë e kampit të Plemetinit, banorëve që janë vendosur në lokalet e reja u ka ndodhur një fatkeqësi. Unë nuk po them që është e rastit për shkak të rrymës elektrike që me siguri instalimi nuk ka qenë në rregull. Një grua u detyrua ta merrte fëmijën e vetë dhe të hidhej nga katër i dytë. Për momentin fëmija është me pasoja shumë të rënda. Meqë këtu është edhe ministri i Komuniteteve kërkoi që Qeveria e Kosovës të kërkojë nga ata që e kanë fituar atë tender se kanë marrë miliona euro, por telat e rrymës i kanë instaluar që kushtojnë 30 – 40 centë, të jadin përgjigje si dhe pse ka ndodhur, kur dihet se nuk është një muaj që kanë hyrë në ato banesa të reja. Shkak i lëndimit të tyre ka qenë zjarri, mbështetje që përfshinë 30 – 40 centë, të jadin përgjigje si dhe pse ka ndodhur, kur dihet se nuk është një muaj që kanë hyrë në ato banesa të reja. Shkak i lëndimit të tyre ka qenë zjarri, mbështetje që përfshinë 30 – 40 centë, të jadin përgjigje si dhe pse ka ndodhur, kur dihet se nuk është një muaj që kanë hyrë në ato banesa të reja. Kërkoi nga ministri i Komuniteteve dhe i Kthimit të jetë në kontakt me Qeverinë dhe me ata që e kanë fituar tenderin, të jadin përgjegjësi për këtë instalim të rrymës.

KRYESUESI SABRI HAMITI – Nekibja po e kërkon fjalën edhe një herë.

DEPUTETJA NEKIBE KELMENDI – Unë u keqkuptova, se kërkova vetëm deklarim që ta gjykojmë shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme e jo ta vlerësojmë situatën si është atje. Dihet, askush nuk mund të shpallë gjendje të jashtëzakonshme në një pjesë të Kosovës.

KRYESUESI SABRI HAMITI – Do t'i lutja këta deputetë nëse e kanë për këtë materie, ta bisedojmë, ta kryejmë dhe të vendosim, nëse kanë problem tjetër do t'ju lus ta zgjidhim atë për të cilin jemi duke biseduar. Fjalën e ka kërkuar deputetja Selvije Halimi.

DEPUTETJA SELVIJE HALIMI – Ju faleminderit z. kryetar. Meqenëse nga deputeti parafolës u ngrit një çështje që ka ndodhur në kampin e Plemetinit, do ta shfrytëzoja rastin dhe do të kërkoj nga ministri i Planifikimit Hapësinor, se ndërtimi i objektit për raste sociale dhe të ngjashme a ka qenë në kompetencë të Ministrisë së tij dhe në se po të raportojë, sepse kemi informacione se këto objekte janë dhënë në përdorim dhe kanë hyrë banorët në to pa pranim-dorëzimin teknik të objekteve. Për të mos vazhduar më tutje do të kërkoj që ministri të na jep shpjegim lidhur me këto objekte.

KRYESUESI SABRI HAMITI – Meqë i dëgjuam prononcimet e shefave të grupeve parlamentare për një ide, për një propozim që bëri deputetja, Nekibe Kelmendi, u përhoqa t'ju dëgjoja kujdeshëm dhe kemi një ide, që megjithëatë po degëzohet, tash për të vendosur që një pikë e rendit të ditës të hyjë si pikë e ngutshme, (urgjente). Ekzistojnë procedura dhe ne do t'i ushtrojmë tash, mirëpo duhet të precizohet se çka duam të

kërkojmë, a po kërkojmë të hartohet një tekst, të diskutohet për temën sot, apo të propozohet që tema të diskutohet një herë tjetër, sepse jemi në këtë nivel. Unë sa dëgjova jo ide të kristalizuara, sepse dolën ide të ndryshme, prandaj kërkoi nga ju që ta miratojmë rendin e ditës, t'u japim rast shefave të grupeve parlamentare të tërhiqen dhe kur të kthehen të na komunikojnë se çka kanë vendosur, në mënyrë që ne të vazhdojmë punën. A pajtohemi? Fjalën e kërkon Xhavit Haliti.

DEPUTETI XHAVIT HALITI – Unë mendoj se çështja nuk është e thjeshtë, kemi pasur raste edhe në të kaluarën të bënim deklarata në Kuvend. Tash e dimë rrjedhën e ngjarjeve dhe mendoj se kryetarët e grupeve parlamentare duhet të takohen me Kryesinë, për ta diskutuar çështjen dhe në qoftë se duhet të merret vendim ta marrin vendimin së bashku. Se Kryesia ka përgjegjësi për ta futur ose jo në rend dite ose Kuvendi, në qoftë se votohet, megjithëtë unë mendoj se është e nevojshme që të takohemi.

KRYESUESI SABRI HAMITI – Fjalën e ka Gani Koci,

DEPUTETI GANI KOçi – Lidhur me atë që shtroi deputetja Nekibe Kelmendi, e kam një propozim : të fuqizohet ajo që në kuadër të kësaj pauze ne, si deputetë të këtij Kuvendi, që jemi 120 t'i marrim dy autobus dhe të shkojmë në Mitrovicë të Veriut të pimë kafe dhe pas dite ta vazhdojmë seancën këtu.

KRYESUESI SABRI HAMITI – Z. Alush Gashi, shefi i grupit më të madh parlamentar, a kërkoni shefat e grupeve parlamentare që të tërhiqeni dhe të na jepni mendimin apo çka kërkoni?

DEPUTETI ALUSH GASHI – Z. kryesues ju e patët një propozim të mirë, rendi i ditës në një farë mënyre u spastrua, dy pikë u hoqën, na jepni mundësi ta miratojmë këtë rend dite dhe na jepni një pauzë që ne të bisedojmë si ta vazhdojmë diskutimin. Grupi Parlamentar i LDK-së, unë në emër të tij dhe lidhur me këtë çështje në kontakt dhe në bashkëbisedim të vazhdueshëm me opozitën, me PDK-në, këtë çështje e konsiderojmë shumë serioze dhe jemi shumë të interesuar që lidhur me të, të bashkëpunojmë dhe të kemi qëndrim të njëjtë, andaj ju lutem të na mundësoni ta bëjmë një pauzë pas miratimit të rendit të ditës.

KRYESUESI SABRI HAMITI – Atëherë e hedhë në votim këtë rend dite pas këtyre votimeve që i bëmë.

Kush është për (Faleminderit)

Kush është kundër..... 1

Konsideroj se u miratua rendi i ditës. Unë u jap mundësi shefave të grupeve parlamentare të tërhiqen dhe të bisedojnë për temën që u shtrua, kurse ne vazhdojmë punën.

Fjalën e kërkon Teuta.

DEPUTETJA TEUTA SAHATQIJA – Z. kryesues, unë mendoj se pauzë do të duhej t'u jepej të gjithëve, jo vetëm shefave të grupeve parlamentare se për këtë çështje duhet të jetë qëndrimi i të gjitha grupeve parlamentare, jo vetëm i individëve. Mendoj se kjo pauzë duhet të jetë e gjithë Kuvendit dhe shefat e grupeve të konsultohen me grupet e veta dhe dalin me qëndrim të përbashkët. Aty kanë me qenë edhe anëtarët e Kryesisë.

KRYESUESI SABRI HAMITI – Jo, shefat e grupeve parlamentare se për atë ne i kemi bërë shefa, ata le të merren vesh dhe na njoftojnë që të merret vendimi në Kuvend, se nuk merret vendim skutave. Ata do të na njoftojnë dhe ne do të marrim vendim.

Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës.

2. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme

Kush ka vërejtje, t'i bëjë me shkrim. Kush e ndien të nevojshme mund të bëjë vërejtje edhe këtu.

Fjalën e ka kërkuar deputetja Naxhije Doçi.

DEPUTETJA NAXHIJE DOÇI - Faleminderit z. diskutues. Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës e kam një vërejtje, sepse në vlerësimin e Projektligjit për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për lëndën arkivore dhe për arkivat e kam bërë vlerësimin në mbledhjen e kaluar, por për shkak të kohës, në marrëveshje me kryesuesin e seancës edhe në bashkëpunim me teknikën, e kamë dorëzuar edhe me shkrim edhe me disketë, kështu që unë e kam kryer obligimin tim, por punimi, ose vlerësimi nuk ekziston në transkript, prandaj vërejtja ime është; të bëhet korrigimi. Ju faleminderit!

KRYESUESI SABRI HAMITI – Problemi është te transkripti. Unë mendoj dhe kërkoj të bëhet ai plotësim në transkripto. Fjalën e ka Safete Hadrgjonaj.

DEPUTETJA SAFETE HADËRGJONAJ - Z. kryesues edhe unë kam vërejte në transkripto, te fjala ime që e kam mbajtur lidhur me raportin e buxhetit të vitit 2005. Vetëm paragrafi i parë, është fjala se unë kam thënë, kurse tërë pjesa tjetër nuk është fjalimi im në transkripto, por nuk e kuptoj pse në tërësi ka dalë tjetër fjali, jo si ajo që unë e kam thënë.

KRYESUESI SABRI HAMITI – Vërejtja u dëgjuua dhe duhet të përcillet te shërbimet përgjegjëse. Nëse nuk ka vërejtje të tjera e miratojmë procesverbalin. A ka kush kundë? Jo, d.m.th. konsideroj se me këto vërejtje u miratua procesverbali i seancës plenare të 1 qershorit 2006.

Kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës.

3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit civil kundër shpifjes dhe fyerjes.

Miratimi në parim i këtij projektligji është bërë me 20.1.2006. Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar dhe Kuvendit ia kanë paraqitur raportet dhe rekomandimet me amendamente. Në bazë të raporteve të komisioneve kryesore dhe të Komisionit për Çështje Gjyqësore, Lgjislacion dhe Kornizë Kushtetuese, si komision funksional dhe raportues (në vazhdim) është paraqitur radhitja e rekomandimeve dhe amendamenteve të tekstit të Projektligjit civil kundër shpifjes dhe fyerjes, si vijon. Komisioni për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese ka vlerësuar se Projektligji civil kundër shpifjes dhe fyerjes e ka bazën juridike në Kornizën Kushtetuese.

Komisioni për Buxhet ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit civil kundër shpifjes dhe fyerjes dhe amendamentet e propozuara nuk përbajnë implikime buxhetore

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit civil kundër shpifjes dhe fyerjes dhe amendamentet nuk i cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Para se të kalojmë në votimet e amendamenteve ju lutem Komisioni përkatës a ka të thotë diçka të veçantë sot.

Fjalën e ka z. Hyseni.

DEPUTETI HYDAJET HYSENI - I nderuari z. kryesues, të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë. Siç jeni të informuar Komisioni për Çështje Legjislative, Kushtetuese e Juridike e ka pasur këtë çështje një kohë të gjatë në shqyrtim, ka organizuar disa shqyrtime të tij, ka organizuar disa dëgjime publike dhe harmonizime me partnerët që kanë punuar bashkërisht në përgatitjen e këtij projektligji. Pra, këtu do të duhej veçuar kontributi i Departamentit të OSBE-së për të Drejtat e Njeriut dhe Sundim të Ligjit, i Departamentit për Media dhe partnerë të tjera të shoqërisë civile, që kanë kontribuar në përsosjen e këtij projektligji. Është nga projektligjet që nuk mund të konsiderohen të një rëndësie të veçantë, siç i konsiderojmë vazhdimisht, por mendojmë se do të ndihmojë shumë në dekriminalizimin që nuk e kishim ndonjëherë në Kosovë të kësaj fushe të legjislacionit. Amendamentet që i keni përpara janë harmonizuar në procesin që e theksova më parë të shqyrtimit të tij të vazhdueshëm dhe mendoj se reflektojnë qëndrimin e ndërtuar me konsensus. Ajo që do të sugjeroja është vetëmse ka një ndryshim në amendamentet që janë përgatitur nga Administrata e Kuvendit dhe amendamentet dhe që janë radhitur nga Komisioni dhe për pasojë është përvjedhur, ose ka rënë një amendment, që mendoj se do të duhej votuar veçanërisht. Amendamenti i 7 i tekstit të Komisionit që është grupim i propozimeve të amendamenteve në gjithë tekstin, aty ku është "shpifa" të shtohet edhe "fyerja", kjo nuk është në tekstin e administratës, mendoj se duhet të procedohet dhe si i tillë të jenë plotësuar kushtet që të miratohet. Unë ju floj që ta votoni dhe ta përkrahni tekstin e propozuar të amendamenteve, të harmonizuar nga Komisioni, Departamenti i Mediave dhe OSBE-së, Komisariati për Media dhe partnerë të tjera të shoqërisë civile që kanë bashkëpunuar me ne. Ju faleminderit!.

KRYESUESI SABRI HAMITI – Dëgjuam mendimin e kryetarit të Komisionit. Ju lus të bëhem gati të votojmë me elektronikë.

Amendamenti 1

Votojmë tash:

Për	56
Kundër	1
Abstenim	1
Kalon amendamenti.	

Amendamenti 2

Votojmë tash:

Për	56
Kundër	1
Abstenim nuk ka	
Kalon amendamenti numër 2	

Fjalën e kërkon z. Jashari

DEPUTETI NAZIM JASHARI – Mendoj se duhet ta konstatojmë kuorumin, sepse 56 + 1 bëjnë 57, duhet t'i kemi 61 së paku, ose nuk po votojnë edhe të pranishmit në sallë ose nuk janë aty.

KRYESUESI SABRI HAMITI – Në sallë janë 62 , por abstenojnë dhe është e drejtë e tyre për të mos votuar. Ju e dini atë.

Amendamenti 3

Votojmë tash:

Për	51
Kundër	1
Abstenim	2
Konstatoj se kalon amendamenti nr. 3	

Amendamenti 4

Votojmë tash:

Për	56
Kundër	1
Abstenim	1
Konsideroj se kalon amendamenti 4	

Amendamenti 5

Votojmë tash:

Për	58
Kundër	1
Abstenim	1
Kalon amendamenti.	

Amendamenti 6

Votojmë tash:

Për 57

Kundër 1

Abstenim 0

Konsideroj se kalon amendamenti.

Amendamenti 7

Votojmë tash:

Për 54

Kundër 2

Abstenim 0

Kalon amendamenti.

Amendamenti 8

Votojmë tash:

Për 54

Kundër 3

Abstenim 1

Kalon amendamenti.

Amendamenti 9

Votojmë tash:

Për 54

Kundër 2

Abstenim 1

Kalon amendamenti.

Amendamenti 10

Votojmë tash:

Për 59

Kundër 1

Abstenim 1

Kalon amendamenti.

Amendamenti 11

Votojmë tash:

Për 57

Kundër 1

Abstenim 1

Kalon amendamenti.

Amendamenti 12
Votojmë tash:
Për 57
Kundër 1
Abstenim 1
Kalon amendamenti.

Amendamenti 13
Votojmë tash:
Për 58
Kundër 1
Abstenime 2
Kalon amendamenti.

Amendamenti 14
Votojmë tash:
Për 59
Kundër 1
Abstenime 2
Kalon amendamenti 14

Amendamenti 15
Votojmë tash:
Për 55
Kundër 0
Abstenime 2
Kalon amendamenti.

Amendamenti 16
Votojmë tash:
Për 50
Kundër 0
Abstenime 3
Kalon amendamenti.

Amendamenti 17
Votojmë tash:
Për 58
Kundër 0
Abstenime 2
Kalon amendamenti.

Amendamenti 18
Votojmë tash:
Për 58

Kundër	3
Abstenime	2
Kalon Amendamenti.	

Tash mund ta votojmë ligjin në tërësi të amendamentuar me amendamentet që i votuam. Në sallë janë 71 deputetë. Ju lutem përdorni kartelat.

Votojmë për Ligjin e amendamentuar në tërësi.

Votojmë tash:

Për	63
Kundër	1
Abstenim	1

Konstatoj se është miratuar Projektligji civil kundër shpifjes dhe fyerjes.

KRYETARI KOLË BERISHA – Vazhdojmë me pikën e 4 të rendit të ditës. Fjalën e ka z. Alush Gashi.

DEPUTETI ALUSH GASHI – I nderuari z. kryetar. Pas konsultimit të të gjithë shefave të grupeve parlamentare të Kuvendit të Kosovës, lidhur me gjendjen e sigurisë në Kosovë e në veçanti në veri të saj , ne kërkojmë nga Kryesia e Kuvendit të Kosovës dhe nga Komisioni i sigurisë që t'i mbledhë të gjitha informatat e mundshme lidhur me gjendjen e sigurisë dhe në veçanti nga Qeveria e Kosovës, KFOR-i dhe UNMIK-u dhe pas asaj të dalë me informatë të plotë në Kryesi e cila së bashku me shefat e grupeve parlamentare të Kuvendit të Kosovës do të marrë vendim për procedim të mëtutjeshëm të kësaj çështjeje shumë të rëndësishme për ne. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA - Ju faleminderit. Vazhdojmë me pikën e 4 të rendit të ditës.

4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për veprimtaritë hidrometeorologjike.

Miratimi në parim i këtij projektligji është bërë më 11.5.2006.

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar dhe Kuvendit ia kanë paraqitur raportet dhe rekomandimet me amendamente. Prandaj shkojmë në miratimin e amendamenteve veç e veç.

Në bazë të raporteve të komisioneve kryesore dhe të Komisionit për Bujqësi, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor si komision funksional dhe rapportues në vijim jepet radhitja e rekomandimeve dhe amendamenteve në tekstin e Projektligjit për veprimtarinë hidrometeorologjike si vijon:

Komisioni për Çështje Gjyqësore, Legislacion dhe Kornizë Kushtetuese ka vlerësuar se Projektligji për veprimtarinë hidrometeorologjike ka bazën juridike në kornizën kushtetuese. Komisioni për buxhet ka vlerësuar se dispozitat e këtij Projektligji dhe amendamentet e propozuara nuk përbajnë implikime buxhetore. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve ka vlerësuar se dispozitat e këtij projektligji dhe amendamentet e propozuara nuk i cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Prandaj mund të kalojmë në votim për secilin amendament veç e veç.

Amendamenti 1

Lus regjinë që të përgatitemi për votim.

Votojmë tash:

Për 66

Kundër 2

Kalon amendamenti.

Amendamenti 2

Për fjalë është paraqitur ministri Ardian Gjini.

DEPUTETI ARDIAN GJINI – Faleminderit z. kryetar. Deputetë të nderuar të Kuvendit të Kosovës, Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor pajtohet me shumicën e vlerësimeve që kanë dalë prej komisioneve parlamentare përkatëse, përpos pjesës së fundit të amendamentit 2, ku thuhet në nenin 3 në rreshtin e parafundit fjalë “studim” duhet të zëvendësohet me fjalën “vlerësim”. Ne mendojmë se duhet të mbetet fjalë “studim” për shkak se “studimi” duhet të përbajë në vetvete vlerësimet dhe do të ketë nevojë për studime të ndryshme që të mos kemi në të ardhmen dilema se a duhet të jetë “studim” apo “vlerësim”. Ju faleminderit.

KRYETEARI KOLË BERISHA – A ka vërejtje Komisioni? Fjalën e ka z. Berat Luzha.

DEPUTETI BERAT LUZHA – Unë mendoj se këtu duhet të jenë të dy termat “studim” dhe “vlerësimi” i ndikimeve të tyre në mjedis.

KRYETARI KOLË BERISHA – Kalojmë në miratimin e këtij amendamenti me propozimin e z. Berat Luzha.

Votojmë tash:

Për 61

Kundër 1

Kalon amendamenti.

Amendamenti 3

Votojmë tash:

Për 61

Kundër 1

Kalon amendamenti.

Amendamenti 4

Votojmë tash:

Për 59

Kundër 1

Kalon amendamenti.

Amendamenti 5

Votojmë tash:

Për 62

Kundër 1

Kalon amendamenti.

Amendamenti 6

Votojmë tash:

Për 60

Kundër 1

Kalon amendamenti.

Amendamenti 7

Votojmë tash:

Për 64

Kundër 1

Kalon amendamenti.

Amendamenti 8

Votojmë tash:

Për 62

Kundër 2

Kalon amendamenti.

Kalojmë në votimin e tekstit të terti me amendamentet e aprovuara.

Votojmë tash:

Për 67

Kundër 1

Konstatoj se aprovohet Projektligji me amendamentet e votuara më parë.

Vazhdojmë me pikën 6 të rendit të ditës.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimet në Ligjin nr. 2004/12 për standardizimin.

Projektligji u është shpërndarë deputetëve më 12 maj 2006 dhe janë përbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin e tij në parim. Vërejtjet parimore do t'i adresohen për shqyrtim komisionit funksional përgjegjës për raportim dhe komisioneve kryesore. Ftohet zëvendësministri z. Kadri Kryeziu që në emër të Qeverisë së Kosovës ta prezantojë para deputetëve Projektligjin.

ZËVENDËSMINISTRI KADRI KRYEZIU - *Inderuar kryetar i Kuvendit, e nderuara Kryesi e Kuvendit,*

Të nderuar deputetë,

Në vijim do të përpinqem të paraqes në vija të trasha qëllimin, rëndësinë, fushën e rregullimit dhe përbajtjen e Projektligjit për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit nr. 2004/12 për standardizim.

Projektligji për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për standardizim ka për qëllim të sigurojë ndryshimet e nevojshme në Ligjin për standardizim, me çka do të krijohen kushte për aplikim të plotë të ligjit.

Ligji Nr. 2004/12 për standardizim është miratuar në Kuvendin e Kosovës më 29 prill 2004 dhe është nënshkruar sipas Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2004/15 më 28 maj 2004 nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përherershëm te OKB-së. Gjatë kësaj kohe, poashtu, është miratuar edhe Ligji Nr. 02/L-20 për kërkeshat teknike dhe vlerësim të konformitetit.

Ligji për kërkeshat teknike dhe vlerësim të konformitetit i përcakton rregullat teknike, deklarimin dhe vlerësimin e konformitetit, në mënyrë te përgjithësuar, andaj me këto ndryshime dhe plotësimet Ligji për standardizim rregullon dhe detajizon aktivitetet e Agjencisë për Standardizim.

Njëherit në Ligjin nr. 02/L-20 për kërkeshat teknike dhe vlerësim të konformitetit neni 19 përcakton se ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji shfuqizohen dispozitat e nenit 7 deri te neni 14 të Ligjit për standardizim.

Me këto ndryshime janë eliminuar paqartësitë në rolin e ushtrimit të kompetencave dhe të përgjegjësive që ka Agjencia e Standardizimit, kurse ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për standardizim do të ndikojnë pozitivisht në rritjen e bashkëpunimit dhe të sinkronizimit të punëve dhe të detyrave të punës në kuadër të MTI-së. Ndryshimet në Ligjin për standardizim dhe rregullimi juridik i tij janë në të njëjtën kohë edhe një premisë për rritjen e besueshmërisë së qytetarëve, për mbrojtjen e shëndetit të popullatës, për mbrojtjen e mjedisit, për sigurinë e përgjithshme dhe për mbrojtjen e resurseve natyrore. Me këto ndryshime mbështetet fuqimisht biznesi kosovar.

Nga ana strukturelle, Projektligji për ndryshimet e ligjit për standardizim është ndarë në gjashtë nene që janë konsideruar nga grupi i punës si bazë e mjaftueshme për rregullimin e ndryshimeve në fushën e standardizimit në Kosovë.

Në nenin 2 hiqen termat dhe përkufizimet e tyre si vijon:
certifikim; kërkeshë; deklaratë e prodhimit te produktit; konformitet; vlerësim i konformitetit; shenja e konformitetit; deklaratë e konformitetit; specifikimet teknike; palë e tretë; produkt; prodhues.

Në nenin 2 - hiqen kreu III, nenet 7,8,9,10,11,12 dhe kreu IV, nenet 13 dhe 14.

Në neni 3 – teksti i nenit 15 hiqet dhe zëvendësohet me tekstin si vijon: për drejtimin, organizimin dhe kontrollin e veprimtarisë së standardizimit dhe të akreditimit në Kosovë, është përgjegjëse Agjencia për Standardizim e Kosovës.

Në nenin 4 – teksti në nenin 17 paragrafët a. dhe b, hiqen dhe zëvendësohet me tekstin si vijon:

a. organizimin dhe përcjelljen e procedurave të hartimit, të miratimit dhe të aplikimit të standardeve dhe

b. organizimin dhe përcjelljen e procedurave të standardizimit dhe të akreditimit, duke u mbështetur në standardet e organizmave ndërkontinentare dhe evropiane të standardizimit.

Të nderuar deputetë,

Duke e pasur parasysh rëndësinë e rregullimit juridik të standardizimit në Kosovë dhe nevojën evidente për krijuimin e një baze të mirëfilltë ligjore të standardizimit, propozoj që pas procedurës së analizimit dhe të shqyrtimit ky projektligj të miratohet në Kuvend për të krijuar në atë mënyrë mundësinë e shpalljes nga ana e PSSP-së. Me këtë projektligj, Kosova do të avancojë kuadrin e saj ligjor në përgjithësi, kurse fusha e standardizimit do të fitojë kornizë adekuate juridike për veprim dhe zbatim në veçanti.

Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Ftoj përfaqësuesin e Lidhjes Demokratike të Kosovës ta marrë fjalën, deputetin Ibush Jonuzi. Urdhëroni.

DEPUTETI IBUSH JONUZI – Ju falëminderit z. kryetar, ministra të nderuar, deputetë të respektuar dhe të gjithë të pranishmit.

Më lejoni që shkurtimisht ta prezantoj arsyen e ndryshimit të Projektligjit për standardizim. Siç e dini, është fjalë për Ligjin nr. 2004/12 për standardizimin, që është nënshkruar me 28.5.2004.

Në momentin e miratimit të ligjit për kërkesa teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit nr. 02/L-20 të nënshkruar me 21.7.2005, Komisioni Parlamentar funksional ka dhënë propozimin se duhet të ndryshohen disa kapituj dhe nene të ligjit të miratuar më parë për standardizim, për çka dhe Ministria për Tregti dhe Industri e ka mbështetur propozimin dhe pastaj ka marrë iniciativën për ndryshimet e bëra. Me këto ndryshime plotësisht pajtohet edhe Zyra për Integrimë Evropiane, sepse janë në harmoni të plotë me ligjet e BE-së. Komisioni Parlamentar për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Miniera, Transport dhe Telekomunikacion i ka shqyrtuar ndryshimet e bëra dhe i propozon Kuvendit t'i miratojë në parim.

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës në parim e përkrah Projektligjin për standardizim me ndryshimet e bëra. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Bajrush Xhemajli.

DEPUTETI BAJRUSH XHEMAJLI – Faleminderit kryetar. Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës i përkrah në parim këto ndryshime të Ligjit për standardizim. Këtë e tha edhe parafolësi, se e ka kushtëzuar, ose e ka iniciuar Komisioni Funksional, për shkak se ka pasur paqartësi dhe disa kolizione në të dy ligjet -Ligi për kërkesat teknike dhe për vlerësimin e konformitetit dhe për standardizimin. Mendoj se me këto ndryshime që po bëhen, të gjitha këto paqartësi do të rregullohen. Faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Fjalën e ka deputeti Bislim Hoti nga AAK-ja.

DEPUTETI XHEVDET NEZIRAJ – I nderuari z. kryetar. Unë jam deputeti Xhevdet Neziraj., pasi nuk pata kartelë e përdora kartelën e z. Hoti. Edhe unë si anëtar i Komisionit, por edhe në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës, i përkrahim këto ndryshime që bëhen në Ligjin për standardizimin dhe eliminohen disa paqartësi që kanë qenë në këtë ligj. Kështu që Grupi Parlamentar i Aleancës përkrah ndryshime që do të ndodhin.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Mahir Jagcilar, në emër të Grupit 6+.

DEPUTETI MAHIR YAGCILAR – Ju faleminderit z. kryetar.

6+ Parlamente Grubu, Standarlara ait Yasa ile ilgili yapılan değişimeleri destekliyor. Önerilen değişimelerle bu Yasanın, daha işlevsel ve daha etkili olacağına inanmaktayız.

Öyleki bu Yasa'nın, ekonomik ve kalkınma koşullarına olumlu olarak etki edeceğini ve dolayısıyla Bakanlık içindeki çalışmaların uyumlaştırılmasını sağlamış olacaktır..

Bizim Grup olarak, değişimeleri desteklediğimizi vurgulamak istiyorum.

Dikkatinise teşekkürler

KRYETARI KOLË BERISHA – Faleminderit. Fjalën e ka deputetja Teuta Sahatqija, në emër të Grupit Parlamentar ORA-

DEPUTETJA TEUTA SAHATQIJA – Faleminderit z. kryetar, pas aprovimit të seçilit ligj paraqitet nevoja e ndryshimit, e qartësimit dhe e amendamentimit të ri. Mendoj që ky rast, në të cilin Ligji për standardizim dhe Komisioni e kanë parë të arsyeshme të bëhen ndryshime, në mënyrë që ky ligj të jetë ligji më i përshtatshëm për zbatim dhe ne si Grup Parlamentar e përkrahim këtë plotësim të këtij ligji dhe kontributin tonë do ta japim në Komision. Ju faleminderit!.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Meqenëse nuk ka kandidatë të tjerë të interesuar për diskutim, kërkoj nga regjia dhe lus deputetët të përgatiten për votim.

Votojmë tash:

Për.....	52;
Kundër.....	1.

Aprovohet në parim ligji në fjalë.

Në bazë të rregullës 23.6 dhe të rregullës 35.2 Kuvendi ngarkon këto komisione.

Komisionin për Ekonomi, Tregti, Industri, Energetikë, Transport dhe Telekomunikacion si komision funksional dhe referues.

Komisionin për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese.

Komisionin për Buxhet dhe Financa dhe

Komisionin për Komunitete.

Komisionet duhet që në afatin jo më vonë se dy muaj pas shqyrimit të parë ta shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportin dhe rekomandimet sipas rregullës 35.6. Ju faleminderit!

Fjalën e ka z. Nazim Jashari. Urdhëroni.

DEPUTETI NAZIM JASHARI – Nuk pat kuorum gjatë votimit të ligjit, kështu që mendoj se është një shkelje e pavullnetshme, por megjithatë mendoj se duhet të konstatojmë gjithmonë para votimit a ka kuorum që të mund të marrim vendime të plotfuqishme. Ne e dimë saktë sipas Rregullores si e kemi përshkruar këtë procedurë, prandaj ,pas që nuk kishte asnjë votë kundër, duhet të plotësohet kriteri elementar i 61 të pranishmëve në Kuvend për të marrë vendime.

KRYETARI KOLË BERISHA – Kërkojmë nga administrata të numërohen deputetët që janë në sallë.

Ftoj deputetë që gjenden jashtë sallës të kthehen në sallë për votim. Nuk e kemi kuorumin. Edhe një herë i ftoj deputetët që nuk gjenden në sallë të kthehen, në mënyrë që të votojmë për ligjin.

Prezent i kemi 60 deputetë momentalisht.

Në sallë momentalisht i kemi 61 deputetë, konstatoj se votimi i parë është i pavlefshëm dhe votojmë për të dytën herë.

Votojmë tash:

Për..... 58;
Kundër..... 1.

Kalon ligji i propozuar.

Ju faleminderit.

Kalojmë në pikën shtatë të rendit të ditës.

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për raportimet financiare të ndërmarrjeve

Projektligji u është shpërndarë deputetëve më 16 maj 2006 dhe janë përbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin e tij në parim. Vërejtjet parimore do t'i adresohen në shqyrtim Komisionit Funksional përgjegjës për raportimin e komisioneve kryesore.

Ftoj përfaqësuesin e Qeverisë, zëvendësministrin z. Behxhet Brajshorin ta prezantojë para deputetëve tekstin e projektligjit në fjalë.
Urdhëroni z. Brajshori.

DEPUTETI BEHXHET BRAJSHORI – I nderuari z. kryetar i Kuvendit, të nderuar ministra, të nderuar deputetë.

Sot para jush po prezantojmë Projektligjin për raportimin financiar të ndërmarrjeve me qëllim që të krijohet një kornizë ligjore ,që do të rregullojë funksionimin e sistemit të raportimit financiar,të kompetencave dhe përgjegjësitë e bordit kosovar për raportim financiar, ndalimin e konfliktit të interesave, keqpërdorimin e informatave, përgatitjen e pasqyrave financiare, nënshtrimin e auditimit, kualifikimet për kontabilistët e certifikuar, licencimin e auditorëve, të firmave vendore dhe të huaja të auditimit.

Ligi është përpiluar duke u bazuar në standartet ndërkombëtare të raportimit financiar dhe të direktivave të Bashkimit Evropian.

Ky ligj është hartuar nga ekspertët vendorë i mbështetur nga ekspertët ndërkombëtarë dhe në bashkëpunim me Zyrën Ligjore të UNMIK-ut, USAID-in, RIINVESTIN, Autoritetin Bankar dhe të Pagesave, Universitetin e Prishtinës dhe të tjera.

Me këtë ligj përcaktohen qëllimi dhe misioni i bordit për raportim financiar të ndërmarrjeve ,që konsiston në: projektimin dhe miratimin e standardeve të raportimit financiar dhe të auditimit ,duke pasur parasysh nivelin e zhvillimit administrativ dhe ekonomik të Kosovës. Të fuqizojë pajtueshmërinë me kërkesat për raportim financiar, të hulumtojë jopajtueshmërinë dhe të imponoje sanksione adekuate. Të formulojë kërkesat për pavarësinë e auditorëve, monitorojë efikasitetin dhe të sigurojë pajtueshmërinë e tyre. Të avancojë dhe të promovojë zhvillimin e theksuar të profesionit të kontabilistikës dhe të auditorit duke adaptuar dhe miratuar standartet e edukimit dhe të tjera profesionale të aplikueshme në vendet anëtare të bashkimit evropian, t'i raportoj dhe të jep këshilla ministrit sipas nevojave dhe kërkesave.

Të nderuar deputetë,

Projektligji për raportimin financiar të ndërmarrjeve përban gjithsejtë 12 kapituj dhe 21 nene, këta kapituj përfshinë:

Kapitulli I - Dispozitat e përgjithshme me të cilët përcaktohet lënda dhe qëllimi i ligjit.

Kapitulli II - Sistemin e raportimit financiar.

Kapitulli III - Funksione dhe përgjegjësinë e bordit kosovar për raportime financiare.

Kapitulli IV - Organizatat e biznesit që e përgatisin pasqyrat financiare për qëllimet e përgjithshme.

Kapitulli V - Organizatat e biznesit afariste që i nënshtrohen auditimit pasqyra financiare për qëllime të përgjithshme.

Kapitulli VI - Kualifikimet e nevojshme për kontabilistët e certifikuar.

Kapitulli VII – Dispozitat për licencimin e auditorëve.

Kapitulli VIII – Dispozitat që i referohen shoqatave profesionale të kontabilitetit.

Kapitulli IX – Dispozita të fundit ndëshkimore dhe të apelimit.

Kapitulli X – Nxjerra e akteve nënligjore për zbatimin e këtij ligji,

Kapitulli XI – Kushtet e përkohshme dhe

Kapitulli XII – Hyrja në fuqi e këtij ligji.

Duke pasur parasysh rëndësinë e këtij ligji ju ftoj dhe propozoj që ky Projektligj të miratohet në parim në seancën e sotme. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës, fjalën e ka deputeti Naser Osmani.

DEPUTETI NASER OSMANI – Faleminderit z. kryetar. Do ta kem fjalën edhe në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa.

I nderuari kryetar, të nderuar ministra dhe kolegë deputetë.

Projektligji për raportimet financiare të ndërmarrjeve ,i miratuar në Qeveri diku në muajin gusht të vitit 2005 ka arritur në Kuvend për procedim të mëtutjeshëm legislativ dhe ka për qëllim ta zëvendësojë Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/30 për themelimin e Bordit të raportimit financier të Kosovës dhe t'i eliminojë zbrastirat e rregullimit të tanishëm juridik në fushën e raportimit financier të ndërmarrjeve, fushat kryesore të cilat i rregullon projektligji janë:

Organizimi, përbërja dhe kompetencat e Bordit Kosovar për raportime financiare, ndërmarrjet që i nënshtrohen detyrimit për të përgatitur pasqyrat financiare dhe të auditimit. Çështjet që kanë të bëjnë me kontabilistët dhe me auditorët, duke përfshirë këtu edhe shoqatat profesionale të kontabilistëve si dhe masat ndëshkimore.

Sipas Kornizës Kushtetuese, kreu 5.7, institucionet e Kosovës kanë për detyrë që ta harmonizojnë legjislacionin me standartet ndërkombëtare dhe evropiane. Në standartet evropiane bëjnë pjesë i ashtuquajturi AKUIS KOMUNITERE e drejta e Bashkimit Evropian, sipas shkresës së 5. shtatorit 2005 Zyra për Integrimë Evropiane e Zyrës së kryeministrat ka konstatuar se Projektligji nuk është në pajtim me AKUIS KOMUNITERE.

Me shkresën e 11 majit 2006 ushtruesi i detyrës të sekretarit të përhershëm të Zyrës së Kryeministrat ka dekluaruar se janë bërë modifikimet e nevojshme të Projektligjit për të harmonizuar me AKUIS KOMUNITERE, mirëpo kësaj deklarate nuk i është bashkangjitur një konstatim zyrtar i Zyrës për Inegrime evropiane mbi të cilën mund të mbështetet deklarata e ushtruesit të detyrës së sekretarit të përhershëm pranë Kryeministrisë. Përveç kësaj më 17 maj 2006, do me thënë 6 ditë pas shkresës së ushtruesit të detyrës të sekretarit të kryeministrat Këshilli dhe parlamenti evropianë kanë miratuar një direktivë të re lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të ndërmarrjeve direktiva 2006/43 EC direktivë kjo e cila duhet pa tjetër të merret parasysh.

Një prej problemeve thelbësore paraqet çështja e pavarësisë së bordit kosovar të raportimit financiar neni 4.1 parashevë që bordi të jetë organ i pavarur prej Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave dhe prej organeve të tjera qeveritare. Nga ana tjetër sipas nenit 3.2 ministri i Ekonomisë dhe i Financave e mbanë të drejtën e mbikëqyrjes së plotë të funksionimit të sistemit të raportimit financiar si dhe të njëjtit i jepet e drejta që të udhëzojë Bordin lidhur me standardet ndërkombëtare për raportimin financiar dhe për standartet e auditimit.

Përveç kësaj neni 4.2. pika e) përcakton se një përfaqësues i MEF-it të jetë anëtar i bordit.

Neni 3.2, 3.4 dhe 4.2 rrezikojnë pavarësinë e bordit sepse i lejon MEF-it hapësirë për të ndërrhyrë në procesin e vendimmarries brenda bordit. Sidomos neni 4.2 pika e) e cila është kritikuar edhe nga Zyra për integrime evropiane në Zyrën e kryeministrat, mirëpo kritika në fjalë nuk është marrë në konsideratë gjatë inkorporimit të vërejtjeve të kësaj zyre.

Sipas nenit 4.2 kryesuesin dhe anëtarët e bordit i zgjedh Kuvendi i Kosovës me propozimin e Qeverisë, ndërsa në nenin 3.2 e drejta për propozimin e anëtarëve të bordit i jepet ministrit të Ekonomisë dhe të Financave.

Këto dispozita duhet të harmonizohen me qëllim që të qartësohet roli i MEF-it në raport me bordin dhe me organet të tjera qeveritare.

Me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/30 veç është themeluar bordi i raportimit financiar të Kosovës, nga Projektligji nuk del qartë se a duhet të vazhdojë ky bord veprimtarinë e tij në përbërje dhe në kompetenca të ndryshuara apo është fjalë për themelimin e një bordi të ri.

Dispozitat materiale në lidhje me raportimin financiar të ndërmarrjeve janë tejet të përgjithshme dhe duket të janë në vazhdimësi të Rregullores si përmendur të UNMIK-ut

Projektligji ,sikurse edhe Rregullorja, nuk i përcaktojë në mënyrë ligjore standardet e kontabilitetit ,por ia delegon këtë kompetencë bordit. Me qenë se është fjala për një ligj për raportimin financiar të ndërmarrjeve, shtrohet pyetja, pse standardet e kontabilitetit të mos përcaktohen drejtpërdrejt me ligj, që nënkupton transformimin e standardeve evropiane dhe të standardeve ndërkontinentale në dispozita ligjore, zbatimi i cilave do të mbikëqyret nga bordi.

Raporti ndërmjet bordit dhe shoqatave profesionale të kontabilistëve dhe në veçanti roli i këtyre shoqatave lidhur me zbatimin e këtij ligji, duhet të shqyrtohet me vëmendje më të madhe, duke pasur parasysh pyetjet që mund të shtrohen ,ndër të tjera, në lidhje me arsyen e delegimit të kompetencave nga bordi në këto shoqata ose licencimin e obligueshëm të këtyre shoqatave nga bordi

Dhe në fund, të nderuar deputetë,

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar ligjin në fjalë dhe ka vlerësuar që për shkak të rëndësisë Projektligji rekomandohet të miratohet në parim, duke pasur parasysh që Komisionin e pret një punë e madhe në amendamentimin e tij. Po ashtu Komisioni merr përsipër të vendosë a duhet të nxjerrë edhe një ligj që ka të bëjë me standardizimin e raporteve financiare apo që në këtë projektligj të inkorporohen standardet e reja për raportime financiare të Këshillit Evropian. Faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Në emër të PDK-së fjalën e ka deputeti Demir Limaj.

DEPUTETI DEMIR LIMAJ – I nderuari z. kryetar, të nderuar ministra të nderuar deputetë. Me gjithë të metat dhe deformime të ndryshme që ka ky Projektligj për raportimet financiare të ndërmarrjeve asariste përkatësisht publike është një Projektligj që është dashur qysh herret të paraqitet para Kuvendit për miratim. Është një Projektligj i veçantë që ka edhe peshën e rëndësisë së veçantë.

Ky projektligj duhet të jetë në harmoni me Ligjin për menaxhimin e financave publike, me Ligjin e prokurimit publik dhe me Ligjin e auditimit, si dhe në përputhshmëri të plotë me direktivat e Këshillit të BE-s. Duke bërë natyrisht modifikimin sipas natyrës dhe të nevojave të biznesit në ekonominë e Kosovës. Për implementimin e këtij projektligji në praktikë parashihet formimi i bordit kosovar për raportimin financiar. Ky bord sipas projektligjit do t'i ketë 7 anëtarë të pavarur që nuk do të kenë funksione politike.

Në kapitullin III, nen 4 pika 4.1. thuhet se kryesuesin e këtij bordi dhe anëtarët i propozon Qeveria dhe duhet të miratohet nga Kuvendi. Mendoj se sipas nevojës , duke caktuar edhe kohën, ky bord duhet edhe të raportojë në Kuvend,kurse Kuvendi e miraton këtë bord. Në Projektligj nuk thuhet një gjë e tillë.

Në kapitullin II ,neni 3 pika 3.2 thuhet se ministri, është fjala për Ministrinë e Ekonomisë dhe të Financave,që ka të drejtën e mbikëqyrjes së plotë të funksionimit, të

sistemimi, të raportimit financiar, duke përfshirë këtu edhe propozimin për emërimin e anëtarëve të BKF-së ,që bie ndeshë me atë se anëtarët e këtij bordit janë të pavarur dhe që nuk do të kenë funksione politike, si dhe me kapitullin II, nen 3 pika 3.3, ku thuhet se ministri nuk ka kompetenca të drejtojë këtë bord.

Siq e potencova edhe më lart edhe në fillim se megjithë të metat dhe deformimet ky projektligj ka rëndësi të veçantë dhe në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës e përkrahim në parim dhe për të gjitha paqartësitë që i ka ky projektligj do ta japim kontributin tonë nëpërmjet amendamentimit dhe sugjerimeve në Komisionin për Buxhet dhe Financa.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Në emër të AAK-ës fjalën e ka deputeti Mazllom Kumnova.

DEPUTETI MAZLLOM KUMNOVA – Z. kryetar, ministra. Grupi Parlamentar i AAK-ës ka shqyrtuar me kujdes Propozimligjin për raportimin financiar të ndërmarrjeve dhe mendoj se ky ligj është më se i nevojshëm dhe shumë i rëndësishëm për funksionimin e sistemit të raportimit financiar për ekonominë e Kosovës edhe pse me 5 vjet vonesë si ligj prioritar që për mungesën e tij sot edhe dje nuk jemi të informuar për gjendjen financiare shumë të përfolur ,sidomos të AKM-ës, PTK-ës, KEK-ut, Aeroportit etj. Më fund me miratimin e këtij ligji krijojmë kushte të një transparence më të shëndetshme financiare.

Dihet mirë se me Rregulloren 2001/30 për themelimin e bordit për raportimin financiar të Kosovës, si dhe të regjimit të raportimit financiar të organizatave asariste është rregulluar pjesërisht puna e bordit të raportimeve financiare ,që do të thotë se nevoja ta kemi një ligj të tillë ka qenë më se e domosdoshme. Po ashtu të gjithë e dimë se rregullorja e cila është në fuqi dhe rregullon këtë fushë është e mangët dhe ka zbrastësi ,nuk është gjithpërfshirëse dhe ka hapësirë me qëllim ose pa qëllim për interpretimin e ndryshëm, prandaj me këtë projektligj është shënuar të krijohet një kornizë ligjoreqë do t'i rregullojë sistemin e raportimit financiar, kompetencat dhe përgjithësitë e bordit të Kosovës për raportim financiar, parandalimin e konfliktit për interesin, keqpërdorimin e informatave, përgatitjen e pasqyrave financiare, nënshtrimin e auditimit ,kualifikimet për kontabilistë të certifikuar ,si dhe licencimin e auditorëve dhe të firmave vendore dhe të huaja. Më sa e njohim këtë fushë projektligji është hartuar në harmoni me standarde ndërkombëtare të raportimit financiar.me direktivat e BE-së dhe duke iu përshtatur nevojave të ekonomisë së Kosovës. Edhe pse mbetet që Komisioni funksional gjatë procedimit të ndërhyjë në pretendimet e sekretariatit të bordit dhe të Ministritës dhe disa çështje të tjera të këtij projektligji kanë mbetur të hapur dhe janë të diskutueshme. Prandaj duke i pasur në dorë këto argumente si Grup Parlamentar e mbështesim në parim këtë projektligj. Faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Në emër të ORA-s fjalën e ka z. Nazim Jashari

DEPUTETI NAZIM JASHARI – Faleminderit z. kryetar, të nderuar ministra ,të nderuar kolegë deputetë. Me një farë mënyre z. Naser Osmani si kryetar i Komisionit foli edhe në emrin tim, por megjithëkëtë ne si Komision i Buxhetit e kemi analizuar këtë ligj para se të vijë në shqyrtim të parë edhe kemi ardhur me synime të përbashkëta, mendoj fondamentale pér këtë projektligj. Këtë e kam thënë edhe në Komision se duhet të përipiqemi t'i harmonizojmë praktikat tonë të raportimit financiar me BE-në, e jo me standartet globale ndërkombe të siç ka ndodhur gjatë hartimit të këtij ligji nga ana e Ministrisë, sepse standartet globale të raportimit financiar vlejnë si pér Nigerinë, vlejnë edhe pér shtetet afrikane, vlejnë edhe pér shtetet e Azisë, kurse ne synojmë të jemi në Evropë, prandaj duhet të përqendrohem i standartet e BE-së pér këtë punë. Në një shkresë përcjellëse të sekretarit permanent të kryeministrisë thuhet që janë harmonizuar qëndrimet, përkundër vërejtjeve të ZPE-së se ky projektligj nuk është konform me standartet e BE-së.

Mendoj, se ky problem i vetëm duhet të tejkalojet, por edhe ne si Komision duhet të përipiqemi të vëmë kontakt me Zyrën pér Integrime Evropiane pranë Kryeministrisë dhe të shohim cilat janë normat që detyrimisht duhet t'I përmirësojmë, në mënyrë që ky ligj të jetë vërtet konform standardeve të Bashkimit Evropian dhe të mos ndodhë të marrim pér bazë standarde që nuk janë praktikë e shteteve në të cilat synojmë të bëhem pjesëtarë edhe ne.

Mendoj se këtu është edhe një element që do të duhej të vihej në spikamë, bordi 7-anëtarësh, që parashihet ta udhëheqë këtë proces në mënyrë të pavarur, më gjithse propozohet nga Qeveria dhe emërohet nga Kuvendi, parashihet të jetë një trup i pavarur irregullues dhe që nga ana e Zyrës pér Integrime Evropiane, pér shkak të dinamikës së ndryshimeve ose të frekuencës së ndryshimeve të normave në BE, propozon që në mënyrë obligative të janë njohës të gjuhës angleze dhe që vështirë mund të saktësohen në ligj ky kusht, mirëpo mendoj se së paku në aspektin preferencial duhet të kërkohet të kenë përparsi ata që e njojin gjuhën angleze, me qellim azhuriteti dhe shpejtësie të aplikimit të normave më të reja të raportimit nga BE-ja në Kosovë.

Pra, mendoj se ka punë Komisioni pér t'i irregulluar këto mangësi që më në fund ta kemi një ligj të mirë. Faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Në emër të Grupit 6+ deputeti Xhezair Murati.

DEPUTETI XHEZAIR MURATI – Dragi predsedniče, kolege poslanici, gospodo ministri i zamenici ministra, Parlamentarna grupa 6+ je detaljno razmotrila Nacrt zakona o finansijskom izveštavanju poslovnih organizacija i u startu imamo primedbu na sastav radne grupe. Takođe, imamo primedbu i na deklaraciju kancelarije procesa Evropskih integracija kada je u pitanju odredba da on nije u skladu sa akvisom Evropske zajednice, jer se ne poziva posebno na načelima iznesenim u upustvima i pravilnicima Evropske zajednice što su i do sada istakli neki od kolega diskutanata. Ovom prilikom bih posebno apostrofirao da se detaljnije formulišu stavovi kada su u pitanju odredbe o konfliktu interesa, jer se o ovome u zemljama razvojenog zakonodavstva prilazi veoma detaljno,

stručno i odgovorno, jer to može biti uzrok mnogih nejasnoća i konfuzija. Takoće bih se i ja zadržao na poglavlje tri ovog zakona gde se govori o kosovskom Bordu i na član 4.3. gde se sugerije da Bord treba da bude multietnički organ i da bude izabran od članova svih regija, dakle da imamo u obzir tu odredbu, zatim ovom prilikom bih takođe apostrofirao izbor revizora da se takođe i tom detalju posveti više pažnje, jer je on lice od ogromnog značaja. Mi prihvatom u načelu da zakon ide u dalju proceduru, ali uz ispravke koje su iznešene i koje smo mi danas izneli. Dakle, Parlamentarna grupa ga podržava mi ga preporučujemo i apostrofiramo da oni propusti koji su napravljeni budu uzeti u obzir i da se oni dopune. Hvala vam!

KRYETARI KOLË BERISHA – Fjalën e ka Rramdan Kelmendi.

DEPUTETI RAMADAN KELMENDI – Ju faleminderit i nderuar kryetar, të nderuar ministra, kolegë deputetë. Vlerësoj se raporti finansiar i ndërmarrjeve është veprim i domosdoshëm i shoqërisë bashkohore dhe me interes të përgjithshëm, por tani në procesin e ekonomisë së lirë dhe në procesin e privatizimit duhet të përdoret nocioni i drejtë ekonomik i ndërmarrjeve. Do të ishte më e drejtë që në vend të..... ndërmarrjeta kemi Ligjin për raportimin e organizatave afariste dhe këtë titull ta mbajë ky propozimligj. Mbështetur në situatën e tanishme rezulton se bordi i raportimeve financiare në Kosovë e ka kryer raportimin finansiar pjesërisht, sepse edhe të drejtat dhe autorizimet ishin të kufizuara në këtë fushë, nga- se Rregullorja kishte mangësi dhe zbrazësi juridike. Pikërisht ky tekst krijon mundësi të bazuar për nxjerjen e ligjit për raportimet financiare të ndërmarrjeve, për ta pasur në fakt një bazë ligjore, në të cilën do të rregullohen sistemi i raportimeve financiare , kompetencat dhe përgjegjësitë e bordit kosovar për raportimin finansiar.

Me këtë propozimligj pretendohet të arrihet të ndalen konfliktet e interesit, keqpërdorimet e informatave, përgatiten pasqyra të informatave, nënshkrime, auditimi, kualifikimi për kontabilistë të certifikuar, licencimi i auditorëve etj.

Vlerësoj se nëse vërtetë dëshirojmë rregullsi dhe ligjshmëri të gjitha këto kritere duhet të vlejnë edhe për firmat e huaja, sikurse edhe për ato vendore që kryejnë afarizëm në Kosovë.

Vërejtja e parë që i adresohet këtij propozimligji është fakti se ky preambulen e fillon me Rregulloren e UNMIK-ut e jo me dispozitat e Kornizës Kushtetuese ,si kërkesë e standarit të ligjit që e ka miratuar dhe e miraton Kuvendi i Kosovës, duke u bazuar edhe në vendimin e Kuvendit të Kosovës që tani disa herë përsëritet në shumë propozimligje të ngashme.

Vlerësoj faktin se lënda dhe qëllimi i propozimligjit janë kryesorë, por kompetenca dhe përgjegjësitë e bordit kosovar për raportimin finansiar nuk arrihet të përcaktohen sa duhet në sasi dhe cilësi. Edhe disa përkufizime nuk janë të drejta, si për shembull me korporatën nënkuptoher organizata afariste e krijuar me Rregulloren 2001/6, që nuk është e vërtetë,prandaj ky përkufizim në aspektin juridik dhe ekonomik nuk qëndron,

sepse një korporatë duhet të ketë së paku 2 apo më shumë kompani dhe të jetë e regjistruar sipas ligjit .

Për të arritur një sistem raportues financiar të standardeve bashkëkohore duhet të aftësohet një personel për fushat e kontabilitetit,për nxjerrjen e akteve dhe të formularëve bashkëkohorë që përcillen si aktivitet financiar në ndërmarrjet e ndryshme asariste të përshtatshme pér rrëthanat e biznesit dhe të ekonomisë së Kosovës, si dhe pér përgatitjen e raporteve auditive të sakta.

Vlerësoj se në kapitullin III bordi kosovar pér raportimin financiar ka paqartësi dhe se kërkohet formulim i qartë me kompetenca të plota dhe profesionalizëm të dëshmuar, përfaqësim adekuat, përcaktim harmonik i honorarit të anëtarëve të bordit. Propozimligji nuk jep zgjidhje në rastet kur anëtari i bordit nuk e ruan fshehtësinë sipas shkallës së përgjegjësisë, as procedurat por as eliminimin e pasojave të mëtutjeshme.

Propozimligji nuk është qartë në përcaktimin e organizatave të biznist që nuk i nënshtronen auditimit, por edhe bordi mendoj se nuk duhet të ketë të drejtë të bëjë licencimin e auditimit të ndonjë firme të huaj, por kjo drejtë të jetë vetëm pér firmat vendore. Propozimligji nuk sqaron formimin e komisionit ekzekutiv që shqyrton ankesat dhe çka ndodh me vendimet e plotfuqishme të këtij këshilli ekzekutiv nëse nuk zbatohen.

Megjithkëto sugjerime, përkrahi në parim miratimin e këtij propozimligji dhe do të parashtroj amendamente me qëllim të begatimit. Ju faleminderit!.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Ali Sadria.

DEPUTETI ALI SADRIA – I nderuari kryetar, i nderuar kryeministër, të nderuar ministra .

Kam kënaqësi të veçantë kur dëgjoj nga të gjitha grupet parlamentare pa përashtim që japid mbështetjen në urgjencën e miratimit të një ligji të tillë megjithë mangësitë eventuale që ka si propozimligj.

Mendoj se ky propozimligj gjatë procesit të amendamentimit do të marrë angazhime dhe kohë. Për t'i harmonizuar të gjitha, duhet ta kuptojmë se standaret nuk janë proces statik ato janë proces dinamik kudo që aplikohen dhe se aplikimi i tyre në kuadër të Bashkësisë Evropiane shpeshherë ndesh në mendime të kundërtë dhe derisa të harmonizohen marrin kohë.

Në Kosovë duhet të kuptojmë se shkalla e zhvillimit ekonomikë është e tillë që nuk mund të aplikohen të gjitha standaret e kontabilitetit. Këtë e kanë edhe shtetet e tjera, në të cilat aplikohen varësish nga niveli i zhvillimit ekonomik. Kosova tanë pér tanë ka vetëm 19 standarde ,për ta ndarë dhe të ecë më shpejt do të jem i kënaqur që kjo të ndodhë dhe duhet të ndodh. Në vende të ndryshme kjo është rregulluar në mënyra të ndryshme. Në shumë vende në vend të këtyre bordeve ka edhe institute që merren me procesin e përvetësimit të standardeve dhe aplikimit të tyre. Për këtë projektligj do të angazhohemi bashkërisht me kolegë të tjerë, megjithatë paraqet tablo të qartë të nevojave të

raportimit,gjë që i mungojnë, do të thotë në një anë të caktuar nëpërmjet amendamentimit do të orvatem i kemi pasqyrë të qartë të raportimeve financiare.

Ky ligj ka edhe një mangësi tjeter,që është se pak ose aspak nuk zë hapësirë të mjaftueshme sistemi i korporatave që e ngriti edhe kolegu. Nuk mund ta adoptojmë një projektligj vetëm për ndërmarrjet e biznesit. Kjo ka një fushë shumë më të gjërë dhe përfshin gjithë ata që merren me biznes dhe me përdorim të buxhetit ose të parashë publike, do të thotë ka një term dhe një determinim që i dedikohen një shtresës më të gjërë se sa një mendim që e dëgjova pak më parë.

Në formulimin e këtij ligji ka edhe çështje të tjera që duhet me precizitet të mjaftueshëm t'i trajtojmë ,cilido që të jetë ndikimi i Ministrisë së Financave, cilado të jetë ndërlidhja e tij dhe sa do të jetë ai në funksion të procesit të dinamizmit të standardeve dhe funksionalitetit të tyre. Unë mendoj se ka mundësi që me vullnet të mirë do t'i arrijmë që të gjitha këto dhe lëshime të tjera që nuk u përmendën e që janë në këtë projekligj gjatë procesit të amendamentimit do të mund të plotësohen. Kuptohet se në çdo rrëthanë them se është vështirë ta matësh nevojën e nivelit të aplikimit të atyre standardeve, po e përsëris ky është proces që në vazhdimësi ky bord duhet ta përcjellë dhe duhet të merret jo vetëm me aplikimin e standardeve, hartimin e atyre, por edhe me trajnimin dhe me përgatitjen e individëve ose të shoqatave për të kryer kësot punësh

Do të angazhohemi të gjithë që ligji,në veçanti, t'i përbajë nevojat specifike të domosdoshme të mbulimit të fushës financiare, them se është një fushë tepër e rëndësishme dhe se ishte nevoja që ky ligj të hartohej dhe të fillonte zbatimi i tij që në ditët e para pas luftës,mirëpo vakuumi i tillë ka sjell mjegull, keqkuptime ,ka pasur përgjithësime të punës së mirë, të menaxhmentit të mirë të menaxhmentit të dobët dhe formave të tjera.

Mendoj se një projektligj i tillë, i hartuar sipas nivelit dhe standardeve të zhvillimit të ekonomisë së Kosovës.do t'i vërë në binarë dhe do të mundësojë që edhe investitorët dhe tatimpaguesit të gjithë të kenë mundësi, të kenë tablo të qarta të afarizmit në ndërmarrje Deri tash jemi dëshmitarë të përplasjeve, por përplasja më e re ishte kur ministri i Financave e kontestoi mënyrën e përllogaritjes së dividendës në botë se është shumë e logjikshme dhe shumë e arsyeshme dhe nuk është e vetmja ajo, ka edhe të tjera, sepse mungesa e këtij ligji ka dhënë mundësi atyre që t'i fshehin ato dhe nuk janë prezantuar në mënyrën adekuatë ,që në një mënyrë është cunguar edhe buxheti i Kosovës. Pra këtu është poenta,prandaj duhet të angazhohemi të gjithë që ky ligj bashkë me ligjin tjeter,që po ashtu është në procedurë edhe ligji për pastrimin e parave, të hartohen dhe të fuqizohen për t'i mbuluar një fushë dhe një boshllëk që ekziston. Faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Gani Koci.

DEPUTETI GANI KOçi - Faleminderit z. kryetar. Do të përpinqem të flas shkurtë, sepse shumicën e atyre që kam dashur t'i them ,i thanë parafolësit dhe dallimi ose ndryshimi ndërmjet qëndrimit tim të tashëm dhe të atyre të deritashme,është se ky projektligj nuk do të duhej fare të shqyrtohej sot në Kuvend, për faktin se e kuptoj dëshirën e Qeverisë që të nxjerrë sa më shumë ligje në Kuvend ,por kur i hynë kësaj pune ,do të duhej të

hartonte dhe ta bënte një analizë të mirëfilltë ,t'i konsultonte ligjet e miratuara ose që janë në procedurë miratimit dhe pastaj të nxjerrë të tjera. Ne kemi pasur Rregulloren 2001/30, që ka rregulluar funksionimin e bordit për raportimin financiar,që po ta shikojmë përmbajtjen e Projektligji nuk ka të bëjë me raportimin financiar, por me funksionimin e bordit për raportim financiar, dhe si i tillë ne kemi pasur një rregullore,prandaj do të duhej që ky projektligj të emërhohej ndryshe ,pra:Ligji për bordin e raportimit financiar dhe jo Ligji për raportimin financiar.

Unë konsideroj se përmbajtja e këtij projektligji do të duhej të ishte pjesë e Ligjit për kontabilitetin që do t'I përcaktonte qartë mënyrat e mbajtjes së kontabilitetit, librat e raportimit financiar dhe çështje të tjera që rregullohen me këtë fushë dhe jo të na vijnë në këtë formë si kanë ardhur deri tani.

Problemi qëndron në atë, sepse bordit të raportimit financiar i jepen disa kompetenca që rregullohen edhe me ligje të tjera. Është Ligji për auditimin që ka përzierje kompetencash,prandaj propozuesi është dashur ta kishte këtë parasysh.Mirëpo në këtë ligj nuk përcaktohet, me asnjë shkronjë,sic e tha edhe parafolësi i fundit cili është raporti dhe çka duhet të përmbajë ai , cilat janë mënyrat e raportimit, absolutisht me asnjë dispozitë nuk përshkruhet.

Çështja tjetër është definimi. Nuk di çka nënkuption propozuesi nacionin ndërmarrje shoqërore dhe çka me ndërmarrje publike. Së paku në sistemin e kaluar ose nga pikëpamja e sistemit të kaluar e dimë se cilat janë dhe çka janë ndërmarrjet shoqërore,por tash ne nuk dimë fare cilat janë ato ndërmarrje shoqërore dhe ku ekzistojnë ato.

Çështja tjetër që vërtetë s'do të duhej të ishte pjesë e shqyrtimit në këtë Kuvend,është edhe deklarata e Zyrës për Inegrime Eropiane. Mua po më duket se është thën edhe disa herë të tjera se Kosova është bërë terren eksperimentimesh dhe se të gjitha ato që nuk janë provuar ende në një vend tjetër, bëhen përpjekje të provohen në Kosovë dhe pavarësisht prej saj se a do të dështojmë apo nuk do të dështojmë.

Ne konsiderojmë se do të duhej t'i kishim përbazë ato standarde, ato norma dhe ato rregulla ndërkombëtare që kanë një përvojë dhe zbatim të deritashëm në vendet e tjera dhe kanë dhënë rezultat pozitiv dhe jo të fillojmë diçka nga e para ,sepse nuk do të duhej që pikërisht ne ,shoqëria jonë kosovare të jetë pjesë e eksperimentit mu në këtë fazë që nuk do të duhej të ishte.

Çështja tjetër që desha ta shtroj këtu është nevoja e Qeverisë që vërtet të marrë sa më shumë kompetenca, por edhe në qoftë se bën përpjekje që të merren këto kompetenca me anë të ligjeve ose vetë me ndryshimin nga një rregullore që ishte në ndryshim ta kthej në një ligj, konsideroj se ligjet e miratuara deri më tani në Kuvend janë shpallur me anë të rregullores. Prandaj nuk do të kishte nevojë fare që t'i quajmë ligje ose t'i përshkruajmë ato rregullore dhe pastaj vetëm t'i emërojม si ligje.

Në fund të fundit po them nëse do të duhej të miratohet ky projektligj propozoj që t'i ndryshohet emërtimi jo të quhet Ligji për raportimin financiar, por Ligji për bordin e raportimit financiar.

KRYETARI KOLË BERISHA – Faleminderit, nuk ishe bash i shkurtër qysh premtove Gani. Fjalën e ka deputetja Nerxhivane Dauti.

DEPUTETJA NERXHIVANE DAUTI - I nderuari zoti kryetar.
Të nderuar deputetë.

Sa i përket shqyrtimit të Projektligjit për raportimin financiar të ndërmarrjeve, unë do të ndalem kryesisht në paraqitjen e disa vërejtjeve thelbësore nga këndvështrimi juridik

1. Vërejta e parë dhe e përgjithshme që e përshkon tërë këtë propozimligj, është teknika e dobët juridike. Nenet janë shumë të gjata, shumë herë konfuze dhe abstrakte. Strukturimi i ligjit është bërë me një teknikë juridike të pazakonshme në përpilimin e ligjeve.
2. Vërejta e dytë, propozoj që ligji të standardizohet dhe të harmonizohen versionet në tri gjuhët.
3. Vërejta e tretë, konsiston në faktin se në tërë ligjin ekzistojnë shkurtesat për organet themelore për raportimin financiar të ndërmarrjeve që në shumë raste përzihen dhe do të paraqesin konfuzion dhe vështirësi tek implementimet e ligjit.
4. Vërejta e katërt propozoj që të harmonizohet ligji me rregulloret e tjera të UNMIK-ut, lidhur me materien thelbësore që rregullon ky ligj – regjimin e raportimit financiar të organizatave afariste apo të ndërmarrjeve, siç bëhet në tërë ligjin.
5. Vërejta e pestë – lidhet me Deklaratën e Zyrës së proceseve të integrimit evropian, sipas së cilës përbajtja e këtij projektligji nuk është në pajtim me Ekuis..... të Bashkësisë Evropiane, sepse nuk referohet në mënyrë të veçantë në parimet e shprehura në udhëzimet dhe në rregulloret e BE-së lidhur me standardet ndërkombëtare të raportimit financiar. Ky ligj i referohet vetëm Komisionit Ndërkombëtarë për Standardet e Kontabilitetit, që kanë për qëllim zhvillimin e një numri unik të standardeve globale të kontabilitetit.
6. Vërejta e gjashtë – ka të bëjë me nenin 3.1 pika i, sipas të cilit sistemi i raportimit financiar, ofron udhëzime të rëndësishme gjithëpërfshirëse në formimin e një opiniioni dhe për të raportuar se a janë raportet financiare në pajtueshmëri me kërkuesat e këtij ligji, por nuk cekën udhëzimet përkatëse që lidhen me to.
7. Vërejta e shtatë lidhet me nenin 3.1 pika c, ku theksohet se duhet ruajtur mirëbesimin e instancave në ekonominë e Kosovës, të lehtësohen ushtrimi i të

drejtave të aksionarëve dhe mbrojtja e palëve të treta, që në te vërtetë duhet të jenë personat e tretë, e në rastin konkret mungon preciziteti

8. Vërejtja e tetë – ka të bëjë me nenin 16.1, nën b, lidhur me lartësinë e gjobave të propozuara. Dënimet e tillë, më konkretisht lartësia e gjobave duhet zbritur. Kjo vlen si për personat fizikë , ashtu edhe për ata juridikë.
9. Vërejtja e nëntë – lidhur me nenin 18, ku theksohet se Bordi kosovar për raportime financiare, do të nxjerrë akte nënligjore, por më konkretisht aspak nuk precizohen.

Megjithë këto vërejtje t ë shumta, të paraqitura, mendoj se duke marrë parasysh rëndësinë e ligjit , duhet të miratohet në shqyrtim të parë në Kuvend, kurse Komisionit funksional i mbeten shumë punë për të përmirësuar cilësinë e ligjit në përgjithësi.

Ju faleminderit !

KRYETARI KOLË BERISHA – Faleminderit. Fjalën e ka deputetja Nekibe Kelmendi.

DEPUTETJA NEKIBE KELMENDI – Faleminderit z. kryetar. Unë kam vërejtje parimore lidhur me këtë ligj vetëm sa i përket titullit të tij. Mendoj se titulli duhet të shkurtohet dhe të jetë vetëm Ligji për raportimin financiar, kurse në brendi të ligjit apo në përbajtjen , ose në preambulë të tij përcaktohen subjektet që i nënshtrohen raportimit financiar, nëse kështu e lënë ndërmarrjet, atëherë friësohem se shumë subjekte do të janë të favorizuara dhe nuk do t'i nënshtrohen raportimit financiar, për këtë arsy mendoj se shumë do t'ua lëmë duart të lira bordit dhe zbatuesve të këtij ligji që t'i numërojë subjektet e detyruara ta bëjnë raportimin financiar më mirë se sa t'u mbetej ndërmarrjeve.

Kemi edhe subjekte të tjera që merren me afarizëm ,për shembull edhe avokatët kryejnë një farë afarizmi edhe mjekët pas orarit të punës bëjnë një afarizëm dhe shumë njerëz të tjerë ,shumë subjekte të tjera .Këta sipas titullit të këtij ligji nuk konsiderohen ndërmarrje, por megjithatë janë të detyruar të raportojnë për afarizmin financiar. Faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Meqenëse nuk ka deputetë tjerë të interesuar për diskutim,

lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, në parim të këtij ligji.
Në sallë janë 71 deputetë.

Votojmë tash:

Për 68;
Kundër..... 2.

Miratohet në parim ky ligj.

Në bazë të rregullës 23.6 dhe të rregullës 35 pika 2 Kuvendi ngarkon këto komisione.

Komisioni për Buxhet dhe Financa si Komision funksional dhe referues.

Komisioni për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizës Kushtetuese, dhe

Komisioni për Komunitete.

Komisionet duhet që në afatin jo më vonë se dy muaj nga shqyrimi i parë të shqyrtojë Projektligjin dhe Kuvendit t'i paraqesin raportin dhe rekomandimet sipas rregullës 35.6. Ju faleminderit.

Kalojmë në pikën e tetë të rendit të ditës

8. Përgjigja e kryeministrit për interpelancë lidhur me Ligjin për vlerat e Luftës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës

Në pajtim me Rregulloren e punës së Kuvendit, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës i është drejtuar Kryesisë së Kuvendit me kërkesë për të ftuar në interpelancë kryeministrin e Qeverisë së Kosovës z. Agim Çeku.

Interpelancën e parashtruar Kryesia ia ka dërguar kryeministrin Çeku për shqyrtim dhe përgjigje në afatin e paraparë me Rregullore të punës. Kryeministri është përgjigjur në përfundimin e Kryesisë, pra sipas udhëzimeve të Kryesisë.

Përgjigjja e kryeministrit u është shpërndarë me kohë të gjithë deputetëve. Ju njoftoj se në pajtim me rregullën 25.7 të Rregullores së punës Grupi Parlamentar i PDK-ës mban të drejtën e fillimit të debatit në kohëzgjatje deri në 10 minuta dhe në përbillje të debatit deri në 5 minuta, ndërsa koha e ndarë për grupet parlamentare do të reflektojë përfaqësimin e tyre në Kuvend për të cilën do ftojë më vonë.

Ftoj përfaqësuesin e paraqitësit të kërkesës për interpelancë ta marrë fjalën. Fjalën e ka z. Jakup Krasniqi.

DEPUTETI JAKUP KRASNIQI – Z. kryetar, z. kryeministër të nderuar deputetë. Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës ka bërë kërkesën për interpelancë për disa arsyе:

Se kemi qenë dhe jemi të bindur se Qeveria e Kosovës, përkatësisht kryeministri, është e obliguar t'i procedojë ligjet në parlamentin e Kosovës që Parlamenti t'i miratojë këto, por dihet se nënshkrimin e fundit në Kosovë, përgjegjësinë për ta vënë firmën, e ka shefi i UNMIK-ut. Ne kemi qenë dhe jemi të bindur se me Ligjin për kategoritë e luftës shumë veta i kanë keqpërdorur detyrën dhe përgjegjësinë që e kishin. Të parët që i kanë, keqpërdorur detyrën dhe përgjegjësinë që e ka shefi i UNMIK-ut, që e dinë shumë mirë

dhe Zyra e tij ligjore si procedohet dhe si kalon nëpër të gjitha fazat një ligj i miratuar në Kuvend dhe se kryeministri është përgjegjës ta e zbatojë, por jo duke dhënë firmën në një ligj.

Ne i kuptojmë vështirësitë që i kanë pasur shefi i UNMIK-ut, ndoshta edhe Qeveria për të simluar para qytetarëve të Kosovës, në mënyrë të veçantë para kategorive për të cilët është nënshkruar ai ligj. Kemi konsideruar dhe konsiderojmë që ai ka qenë një mashtrim, që u është bërë opinionit dhe kategorive që duhet të përfitojnë nga ai ligj e që nuk janë duke përfituar. Nuk di në shërbim të kujt ka shkuar këto parregullsi, këto shkelje procedurash dhe ky mashtrim që u bëhet edhe Kuvendit edhe deputetëve edhe opinionit.

Një çështje tjeter që do të dëshiroja ta ngritja është se zakonisht po vonohen interpelancat dhe po relativizohen ato, se vërtet po kalojnë nëpër një procedurë të gjatë disa çështje shumë aktuale dhe po e humbin aktualitetin. Për një gjë të tillë mendoj se rruga nga kërkesa e interpelancës deri në realizimin e saj duhet më e shkurtër, edhe pse përveç këtij relativizimi ka edhe relativizime të tjera. Sa herë Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës ngrit çështje të kësaj natyre bdodhin relativizime në disa forma, një formë është vonesa dhe forma tjeter është që dikush nga deputetët e Partisë Demokratike që kërkon interpelancën, gjenden në thumb të kritikës se mjeteve të informimit, që nuk dihet se nga cilat mjete financohen. Ne e kemi bindjen, se po të ketë grup hulumtues, që hulumton disa mjete të pavarura në Kosovë, do të përfundonte se ato mjete të informimit financohen nga mjetet e qytetarëve të Kosovës. Prandaj, ata vihen në mbrojtje të shkeljeve të ligjeve që behën në vazhdimësi nga Qeveria e Kosovës dhe qeveritarët në Kosovë. Kisha dëshiruar dhe kërkoj nga kryeministri të deklarohet cilat kanë qenë arsyet e tjera që janë bërë ky simulim dhe ky mashtrim i opinionit për nënshkrimin e një ligji, që edhe ka qenë ndryshuar dhe kishte qenë i ndryshuar, jo në atë formën që është miratuar në Parlament, do të thotë, përveç simulimit dhe mashtrimit, ligji është ndryshuar dhe ndryshimet nuk kanë mund të ndodhin në një ligj të nënshkruhet me ndryshimet e pamiratuara dhe të kthyera në Parlamentin e Kosovës, do të thotë, në këtë procedurë ka shume shkelje dhe dikush për të gjitha këto shkelje duhet të japë përgjegjësi, ndoshta përgjegjësia nuk është vetëm e shefit të UNMIK-ut. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit z. Krasniqi. Ftoj kryeministrin zotëri Çekun ta marrë fjalën

KRYEMINISTRI I KOSOVËS Z. Agim Çeku
Inderuari kryetar i Kuvendit,
Të nderuar deputetë,
Të nderuar ministra

Që nga momenti kur e kam marrë postin e kryeministrit, kam shprehur gatishmërinë time për t'i dhënë llogari këtij Parlamenti dhe përmes tij edhe qytetarëve të Kosovës, sa herë kërkohet prej meje, sa herë që është e nevojshme. Për t'i mbetur besnik këtij përkushtimi, unë kam pranuar pa asnjë hezitim. Ftesa e Grupit Parlamentar të PDK-së

për interpelancë, lidhur me Ligjin për Vlerat e Luftës, dhe pse këtë çështje e kam sqaruar disa herë publikisht edhe në media. Për këtë çështje, gjithashtu, e kam dërguar një letër të veçantë dhe i kam njoftuar të gjithë Kryesinë e Parlamentit të Kosovës. Por, për të qenë deri në fund transparent dhe i sinqertë para këtij Parlamenti dhe për ta plotësuar kërkesën e Grupit Parlamentar të PDK-së, po i përsëris edhe një herë në mënyrë kronologjike gjërat që tashmë janë të njohura edhe për opinionin.

Sic jeni në dijeni, që nga dita e parë e punës sime si kryeministër në fokus të angazhimeve të mia ka qenë mbrojtja e vlerave të luftës dhe përkujdesja për kategoritë të dala nga lufta. Këtë e kam ndierë si obligim institucional, por mbi të gjitha edhe si obligim moral ndaj shokëve dhe ndaj bashkëqytetarëve të mi. Për të qenë sa më pranë hallevë dhe shqetësimeve të këtyre kategorive, kam angazhuar një këshilltar të posaçëm për vlerat e luftës, i cili është në kontakt të vazhdueshëm me shoqatat e kategorive që i përfaqësojnë këto vlera. I nxitur nga dëshira e madhe dhe qëllimi i mirë, që këtyre kategorive t'u ofrohet sa më shpejt përkujdesja institucionale, që nga dita e parë e punës si kryeministër kam insistuar te z. Jesen Petersen që të nënshkruhet Ligji për vlerat e luftës, i cili më parë është aprovuar nga ky Parlament. Pas bisedave të shumta me z. Jesen Petersen, i cili ka treguar vullnet të mirë për zgjidhjen e kësaj çështjeje të ndjeshme, është bindur ai për nënshkrimin e ligjit. Ky ka qenë momenti im më i lumtur për kohën sa kam qenë në detyrën e kryeministrit.

Me 2. maj, në zyrën time bashkë me z. Jesen Petersen kemi organizuar një takim për këtë çështje të rëndësishme. Në takim kanë qenë prezentë edhe ministri i Punës dhe i Çështjes Sociale, z. Ibrahim Selmanaj, këshilltari për vlerat e luftës z. Arif Muqolli dhe drejtuesit e tri shoqatave që përfaqësojnë vlerat e luftës, kështu që, në atë takim është marr pajtimi dhe vendimi që ky ligj të nënshkruhet nga ana e z. Jesen Petersen, pasi që ishin prezentë të gjitha palët e interesuara për këtë ligj, ishin prezentë edhe mediat. Gjatë takimit z. Jesen Petersen më sugjeroi aty për aty dhe ka insistuar që edhe unë në prani të mediave të bëj një gjest simbolik nënshkrimi, edhe pse dihet se nuk është në kompetencën e kryeministrit që të nënshkruhen ligjet e aprovuara nga Parlamenti. Për këtë i kam dëshmitarët z. Jesen Petersen, ministrin Selmanaj dhe drejtues të shoqatave që përfaqësojnë. Për këtë gjest simbolik, unë e kam shprehur dhe shprehi keqardhjen time edhe pse nuk kam bërë ndonjë shkelje ligjore, sepse asgjë nuk është nënshkruar vetëm është bërë një gjest simbolik se po e nënshkruajmë Ligjin pas marrjes së vendimit, se Ligji të nënshkruhet. Por gjatë tërë kohës në tavolinë e kemi pasur temë diskutimi, e kemi pasur Ligjin në formë dhe përbajtje të aprovuar nga ky parlament.

Unë dëshiroj të shpreh faleminderimin tim për drejtues të shoqatave që e përfaqësojnë vlerat të luftës dhe për këto kategori të cilave u dedikohet ky ligj, që e kanë kuptuar si duhet këtë gjest simbolik ashtu sic e kanë kuptuar drejtë përkushtimin dhe angazhimin tim të sinqertë për këtë çështje.

Gjatë takimit z. Jesen Petersen e ka ngarkuar këshilltarin e tij ligjor që ishte përgjegjës në atë takim që të përgatis teknikisht Ligjin për nënshkrim. Duke pasur parasysh, faktin se gjatë takimit kemi pasur përpëra vetëm ligjin në formë sic është aprovuar në Parlament, ne kemi qenë të bindur se Ligji do të nënshkruhet pa bërë asnjë ndryshim. Dua t'ju

siguroj se as unë as ministri Selmanaj as drejtuesit e shoqatave të dala nga lufta as këshilltari ligjor as Zyra ime ligjore nuk ka qenë të informuar për ndryshimet terminologjike që janë bërë më vonë në letrën përcjellëse të cilën e ka hartuar Zyra ligjore e UNMIK-ut si aneks të ligjit dhe të cilën më vonë e ka nënshkruar z. Jesen Petersen. Për këto ndryshime përbajtësore jam njoftuar më vonë dhe menjëherë i kam shkruar një letër z. Jesen Petersen me të cilën kam shprehur zhgënjimin tim të madh dhe mospajtimin për këto ndryshime dhe kam kërkuar sqarimin prej tij, një kopje të kësaj letre ia kam dërguar bashkangjitur letrës që ia kam dërguar Kryesisë së Parlamentit të Kosovës.

Për ta diskutuar këtë çështje, me 11 maj, të nesërmen pasi është kuptuar se për ndryshime, kemi organizuar një takim të përbashkët me Ministrinë e Punës dhe të Çështjeve Sociale, ku kanë qenë të pranishëm: zëvendës i kryeadministratorit i UNMIK-ut z. Stiven Shup, ministri Selmanaj dhe drejtuesit e të tri shoqatave që i përfaqësojnë vlerat e luftës. Ne i kemi shprehur mospajtimet tonë për këto ndryshime zëvendëskryeadministratorit z. Shup dhe kemi kërkuar prej tij që Ligji të pezullohet dhe këto ndryshime të rishqyrtohen. Të njëjtat shqetësime dhe të njëtin qëndrim ia kam përcjellë të nesërmen z. Jesen Petersen në takimin e rregullt, të mbajtur më 12 maj, në këtë takim me z. Jesen Petersen jemi dakorduar se kjo çështje të rishqyrtohet dhe Ligji të dërgohet edhe një herë në Zyrën ligjore të OKB-së në Nju Jork. Ligji tanimë është dërguar atje dhe jemi në pritje të një përgjigjeje, përgjigje adekuate. Kjo është historia e vërtetë e kësaj çështjeje dhe çdo përpjekje për ta politizuar apo përfituar prej saj është jo e ndershme. Dëshiroj në fund të rikonfirmoj edhe para këtij Parlamenti se gjithnjë, në çdo vend dhe në çdo kohë unë do t'i mbroj vlerat e shenja të luftës, këto janë vlera universale dhe kohezive. Në të njëjtën kohë, dëshiroj t'i sigurojë të gjithë qytetarët e Kosovës dhe në radhë të parë kategorive të cilëve u dedikohet ky ligj se angazhimi im në këtë çështje ka qenë dhe do të vazhdojë të jetë krejtësisht i sinqertë, qëllimmirë dhe transparent. Për mua si kryeministër është i pranueshëm Ligji për vlerat e luftës vetëm në formën sic është pranuar nga ky Parlament. Ju faleminderit !

KRYTARI I KUVENDIT TË KOSOVËS – KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Berat Luzha

DEPUTETI BERAT LUZHA - Z. kryetar, i nderuar kryeministër, deputetë
Është bërë praktikë që kohëve të fundit ligjet që i miraton Kuvendi i Kosovës të ndryshohen nga Zyra Ligjore e UNMIK-ut dhe një nga këto ndryshime ka pasur edhe Ligji për vlerat e luftës. Zyra e UNMIK-ut ka të drejtë t'i shqyrtojë ligjet dhe t'ia propozojë sekretarit, Përfaqësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm nënshkrimin apo mosnënshkrimin dhe se Përfaqësuesi I Sekretarit të Përgjithshëm ka të drejtë ta nënshkruajë ose t'ia kthej Kuvendit ligjin me vërejtjet e bëra. Në të kundertën mendoj se cenohet autorësia e ligjeve nga ana e Kuvendit të Kosovës. Në këtë drejtim Kuvendi i Kosovës dhe Qeveria duhet t'i mbrojnë ligjet që miratohen këtu në Kuvend dhe jo ligjet që ndryshohen njëanshmërisht nga ana e Zyrës Ligjore të UNMIK-ut.

Unë propozoj që Kuvendi të marrë qëndrim që t'i shpallë të pavlefshme të gjitha ato ndryshime që janë bërë nga Zyra Ligjore e UNMIK-ut dhe që nuk janë shqyrtuar nga Kuvendi i Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT TË KOSOVËS – KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Naim Maloku

DEPUTETI NAIM MALOKU - Ju faleminderit z. kryetar, i nderuari z. kryeministër, të nderuar deputetë

Më lejoni që në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së ta falënderoj kryeministrin e Kosovës, z. Agim Çeku për gatishmërinë e tij që t'i përgjigjet interpellancës të deputetëve të Kuvendit të Kosovës. Më lejoni z. kryetar që në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së ta falënderojlë kryeministrin Çeku për sqarimet e paraqitura edhe me shkresë të dërguar Kryesisë së Kuvendit të Kosovës dhe deputetëve, si dhe për sqarimet e dhëna gojarisht para deputetëve të Kuvendit të Kosovës. Grupi Parlamentar i AAK-së, të nderuar deputetë dhe z. kryetar beson në angazhimin permanent dhe të vendosur të kryeministrat Çeku për ta përmirësuar gjendjen dhe statusin e kategorive të dala nga lufta, jemi të bindur se kryeministri Çeku është i lidhur me këto kategori edhe vetë nga e kaluara e tij bashkë me njerëzit e këtyre kategorive dhe emocionalisht z. Çeku është i lidhur edhe me situatën e tyre jo të mirë dhe do të përpinqet që kjo të përmirësohet.

Të nderuar deputetë, Grupi Parlamentar i AAK-së shpreh gatishmërinë të marrë pjesë aktivisht në iniciativë e procedurës që Ligji tashmë i nënshkruar nga z. Petersen ta marrë formën që e ka pasur kur është miratuar në Kuvendin e Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT TË KOSOVËS – KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Gjergj Dedaj

DEPUTETI GJERGJ DEDAJ – Ju faleminderit shumë zoti kryetar, i nderuar z. kryeministër, ministra, kolegë deputetë

Atëherë kur e kemi miratuar në Kuvend këtë ligj edhe një herë duhet të theksoj sa për informim të opinionit se nuk jam pajtuar dhe asnjëherë nuk do të pajtohem që njerëzit tonë më të dashur që janë vrarë, ekzekutuar gjatë luftës në Kosovë, me këtë ligj i keni trajtuar si persona të vdekur gjatë luftës në Kosovë. Nëse nuk është kështu, shfletojeni ngadalë dhe me kujdes ligjin dhe ju do ta shihni se ashtu e keni bërë dhe kjo është d.m.th e padrejtë, johumane, e pandershme që qytetarët, njerëzit tanë, familjarët tonë, që janë vrarë dhe ekzekutuar gjatë luftës, siç dikush pretendon ta quajë njëfarë konflikti në Kosovë, d.m.th t'i trajtojë personën të vdekur sikur të kishin vdekur nga gripi apo nga ndonjë sëmundje tjeter ngjitet. Unë vi, më vjen keq ta them nga një familje me dhjetëra të vrarë dhe të zhdukur që edhe sot kam të zhdukur, nga një vend me shumë të vrarë dhe të zhdukur si dhe shumë deputetë të këtij Kuvendit të Kosovës. Sa për kujdesin që po thuani që e ka treguar Qeveria për këto kategori mund të them se mund të jemi vetëm sot” të lumtur “kur në Gjakovë te këto familje shkon për të kënduar Ana Oaska

dhe deri më tash mund t'ju them me shifra, me fakte ka vendbanime kur 25% të një fshati janë të vrarë, të zhdukur dhe askush kur këmba e as një ministri, as një qeveritari dhe asnë strukture politike të Kosovës nuk e ka shkelur, prandaj nuk qëndrojnë këto të dhëna se ka interesim për këtë kategori që është më meritore. Por, mund të them më e diskriminuara në Kosovë siç janë: familjet e dëshmorëve; siç janë invalidët e luftës; siç janë ish-ushtarët e UÇK-së; siç janë martirët; - që i keni quajtur persona të e vdekur-d.m.th. mund të them se ata janë të vrarë dhe janë martirë të Kosovës.

Kam thënë se edhe propozoj që ky ligj edhe një herë të kthehet te sponzoruesi, të korrigohet, t'i kthehet Kuvendit të Kosovës, dhe të japim një trajtim korrekt, të ndershëm dhe meritor të gjitha këtyre kategorive dhe këtyre njerëzve të cilët me jetën e tyre e kanë dhënë për Kosovën, d.m.th. mos të luhet me këto kategori, sepse po luani me dinjitetin dhe nderin tonë. Ju faleminderit .

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Alush Gashi.

DEPUTETI ALUSH GASHI – I nderuari z. kryetar i Kuvendit. Grupi Parlamentar i LDK-së qëndron pas tekstit të votuar në Kuvendin e Kosovës, dhe nuk pranon ndryshime të atij teksti pa pjesëmarrje të votës së Kuvendit të Kosovës. Lidhur me paraqitjen e sotme të z. Kryeministrit ne e pranojmë deklaratën e kryeministrit, për shprehje të keqardhjes lidhur me stimulim të nënshkrimit. Për ne nënshkrimi është inokzistent dhe kërkojmë sjellje serioze institucionale në institucionet e Kosovës. Ju faleminderit z. kryetar.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Sabit Rrahmani.

DEPUTETI SABIT RRAHMANI – Ju faleminderit z. kryetar, i nderuar z. kryeministër, të nderuar ministra, të nderuar deputetë.

Do të jem shumë i shkurtër. Unë kam vetëm një propozim. Meqenëse z. kryeministër tha që ligji tashmë është përcjellë në Zyrën Ligjore të Organizatës të Kombeve të Bashkuara në Nju Jork. Unë propozoj që Kuvendi të dalë me një qëndrim ose me një deklaratë që sot t'i drejtohet sekretarit të përgjithshëm z. Kofi Anan që në atë ligj të mos ndryshohet asgjë. D.m.th. para se të marrë përgjigje Kuvendi i Kosovës të dalë me një deklaratë që i drejtohet atij, se ligji I miratuar në Kuvend të jetë i njëjtë si ka dalë nga Kuvendi. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit ! Fjalën e ka deputetja Fatmire Mulhaxha Kollçaku.

DEPUTETJA FATMIRE MULHAXHA – KOLÇAKU - Ju faleminderit z. kryetar.

Dësha vetëm ta cek një gjë, që falë përkushtimit shumë të madh të Komisionit Parlamentar për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale ,që ka bashkëpunuar ngushtë me Ministrinë për Punë dhe Mirëqenie Sociale , ne e kemi pasur këtu versionin e fundit të ligjit për vlerat e luftës,që edhe është votuar në Kuvend. Ne si Grup Parlamentar i Partisë

Reformiste ORA, është normale ta mblështesim versionin që është votuar këtu në Kuvend. Por mund ta cek që edhe në momentin e nënshkrimit të këtij ligji nënshkrimi i fundit pas nënshkrimit të kryetarit të komisionit, që e ceka është dashur të jetë nënshkrimi i z. Jesen Petersen, megjithëse në atë moment nuk është ftuar asnjë përfaqësues i komisionit ,që i ishte më meritor që një projektligj i tillë erdhi në seancë dhe u votua për të. Megjithkëtë nëse e dimë që këshilltari i kryeministrat është dashur të informohet , mirëpo e dimë se kryeministri ka shumë punë dhe nuk mund të jetëçdo herë i informuar për çdo detal, por një këshilltar i angazhuar veçanërisht për një çështje të tillë, është dashur paraprakisht të jetë i informuar rreth asaj se çka është në tryezë atë ditë dhe çka nënshkruhet.

Versioni i votuar në Kuvend për ne është versioni i fundit, prandaj duhet të fuqizohet, përndryshe vetëm Kuvendi mund ta ndryshojë madje edhe po të s ishte kthyer në Kuvend. Kjo është ajo që desha të them. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Xhavit Haliti

DEPUTETI XHAVIT HALITI – Personalisht për shumë çështje të ligjt dhe përmënyrën e trajtimit që i është bërë kësaj kategorie në ligj, nuk pajtohem, megjithatë ligji është miratuar në Kuvend dhe jemi të obliguar të gjithë që këtij votimi t'i nënshtron hemi dhe ta respektojmë. Do ta kisha lutar kryeministrin që të paktën tjetër herë të mos del para mediavdhë të simulojë as ashtu as kështu se s'ka nevojë të dalë. Nuk është përgjegjësi e tij t'i nënshkruaj ligjet, mund takohet me kryeadministratorin e të bisedojë për t'i trajtuar problemet dhe mua do të më vinte mirë në qoftë se kryeadministratori do t'i kishte thënë kryeministrin që do t'I ndryshojmë çështjet dhe do ta trajtonin këtë problem, kurse ta nënshkruajnë me ndryshimet e propozuara nga vetë kryeadministratori, apo t'i rikthehet në shqyrtim Parlamentit të Kosovës. Kjo është krejtësisht normale ose e fundit do të duhej ta merrite vetë një vendim. Nuk jam shumë i sigurtë se a ka të drejtë apo jo ta tërheqë ligjin e tillë të ndryshuar.

Megjithatë, unë mendoj që për t'u zbatuar ky ligj ,sipas informacioneve që kemi, ka shumë vështërsi. Vështërsia kryesore është buxheti i vogël i Kosovës dhe mundësia që nga ky buxhet këto kategori të financohen, prandaj propozoj që krahas vërejtjeve qellimmira që do t'i bëhen, mendoj se institucionet do të funksionojnë normalisht, mëgjithëse sot ndihet mungesë e fondevë dhe e buxhetit për këtë kategori. Mendoj se Qeverisë i takon ta zbatojë një taksë të veçantë për biznesmenët e Kosovës, që të paguajnë përfondin e kësaj kategorie, sepse konsideroj që edhe këta biznesmen ,që po krijojnë pasuri për çdo ditë në Kosovë, e kanë peshqesh pikërisht nga kjo kategori ,që ka dhënë jetën përlirinë e vendit tonë. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Sabri Hamiti

DEPUTETI SABRI HAMITI – Kolegë të nderuar, z. kryeministër. Pa hezitim dola t'i them nja dy tri fjalë lidhur me seancën e sotme dhe me problemin e kësaj interpelance.

Unë mendoj që definitivisht në Kuvendin e Kosovës po funksionon demokracia , po funksionon ajo që unë pa gjetur ndonjë shprehje më të mirë e kam quajtur disiplinim institucional. Këtë formulim më nuk do ta ndërroj, sepse mendoj se ky formulim është një realizim i asaj që quhet demokraci në nivelin e institucioneve.

Unë e përgëzoj Partinë Demokratike që ka kërkuar interpellancë për kryeministrin, për një problem që ka implikuar dy probleme.

1. Sepse ka qenë i lidhur me një ligj shumë të ndjeshëm dhe me një kategori shumë të ndjeshme të shoqërisë sonë, me një ligj të cilin kanë punuar dy legjislatura dhe pa marrë parasysh gjendjen në të cilën është ai sot, ai ka qenë megjithatë një koncensus i këtij Kuvendi dhe unë e përgëzoj Kuvendin që e ka nxjerrë ligjin.
2. Pse kryeministri nuk ka hezituar për asnjë minutë që të dalë para parlamentit dhe të përgjigjet për veprimet e tija.

Unë e di se veprimet e tij nuk janë institucionale ,sepse kryeministri e di sigurisht edhe këshilltarët e tij e dinë që pushteti këtu është i ndarë, demokracia dhe ekziston pushteti legjislativ që e ka ky vend dhe ai ekzekutiv që e ka Qeveria e tij bashkë me ministrat e tij. Fundi i fundit këto i dinë të gjithë.

Unë e di që gjesti është bërë për një promovim ta quajë unë politik të ligjit, se ndryshe nuk ke si e quan kur mblidhen bashkë kryeadministratori që ka drejtë për ta nënshkruar, kryetari ekzekutiv dhe përfaqësues të shoqatave që implikohen në të ,ta quajë lojë, pa kuptim të keq, tash kanë hyrë gjitha në të dhe kurrikush në këtë rast nuk mungon, d.m.t.h. nëse janë mashtruar janë mashtruar të gjithë , vullnetarisht apo jovullnetarisht . Unë e di që do të më thuhet se nuk e kanë ditur çka kanë shkruar atje. Po pse atëherë të nënshkruhet qoftë edhe në formën e një vullneti personal,të një dëshire e dashurie, që nuk e dinë se çka shkruan aty, d.m.th. kjo vlen për të gjithë..

Prandaj, unë mendoj që edhe një herë po them është çelësi i demokracisë mënyra e të menduarit dhe të diskutuarit këtu. Unë i përgëzoj njësoj, kryeministrin Agim Çeku dhe Grupin Parlamentar të PDK-së të krijojnë dialogun e këtij niveli këtu. Ju faleminderit

KRYETARI KOLË BERISHA –Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Hajredin Hyseni

DEPUTETI HAJREDIN HYSENI – Ju faleminderit z. kryetar, z. kryeministër, ministra të pranishëm, deputetë të nderur.

Do ta kuptoja dhe do të mund ta falja z. kryeministër në qoftë se këtu në Parlament do të kërkonte falje për veprimin e tij të bërë për ligjin, por nuk e kuptoj kryeministrin pse mundohet prapë ta simulojë Parlamentin dhe të thotë pasi jemi mbledhur rastësisht, ne kemi vendosur ta nënshkruajmë ligjin dhe mua më ka lutar Peterseni. Mendoj se ai bëri një gabim të dytë ,se ata janë mbledhur pikërisht për ta nënshkruar ligjin dhe unë do të propozoj që ky Kuvend ta tërheqë atë ligj. Pra, mendoj se kryeministri nuk ka qenë i qartë në sqarimin e tij,sepse do të duhej të tregonte pse ata janë mbledhur për ta nënshkruar

ligjin dhe me këtë përgjigjeje bën edhe një gabim të pafalshëm në vend që të kërkonte falje për jokompetencë që nuk ishte e tij që e ka nënshkruar një ligj apo e ka simuluar para opinionit për përfitime politike. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit!, fjalën e ka deputeti Gani Koci.

DEPUTETI GANI KOCI- Nuk do të kërkoja nga kryeministri të jetë mbi nivelin e institucioneve të tjera të Kosovës, si është Presidenca, ky Kuvend, por edhe Qeveria e ministritë veç e veç, pikërisht për faktin se tani e 7 vjet pas lufte në këto institucione ende ekziston dilema se vërtetë a ka pasur luftë në Kosovë, a ka pasur konflikt në Kosovë, do të thotë ne e kemi këtë dilemë dhe përderisa në mesin tonë ekziston kjo dilemë, natyrisht se të tjerët shumë më me lehtësi do të kalojnë. E kuptoj z. kryeministër se ai më së miri e di, madje nga pikëpamja ushtarake, se ka qenë pjesë e luftës, se vërtetë a ka pasur luftë apo konflikt në Kosovë, rrëth kësaj çështjeje nuk do të duhej të diskutohej shumë. Por, nuk kuptohet ajo që vërtet të bëhen simulime të tilla qoftë edhe simbolike për faktin se ne do të kemi edhe raste të tjera të nënshkrimeve të dokumentacioneve shumë të rëndësishme dhe pastaj mund të na dalin me bisht këto dokumentacione. Dhe të themi kemi simuluar, s' kemi lexuar, s' kemi ditur çka kishte në to. Dhe kështu prej një lajthitjeje në lajthitjejen tjetër edhe më të madhe.

Parafolësi im tha se është gjest i mirë një promovim publik i këtij ligji politik. Unë konsideroj se nuk ka qenë një promovim publik ose politik I ligjit, por përpjekje e një promovimi politik të një individi, në këtë rast të kryeministrat, sepse jam i bindur se asnë nga këshilltarët e tij nga niveli i përgatitjes së tyre profesionale, sikur të ishte këshilluar me ta, se a të shkojë edhe në këtë formë, nuk do t'i thoshte të shkojë atje. Insistimet kanë qenë dikund tjetër dhe pikërisht për të mbuluar këto ndryshime dhe të kalojnë shkel e shko. U bashkëngjitem propozimeve të parafolësve që Kuvendi ka shpallur të miratuar këtë projektligj dhe ky Kuvend ka të drejtën ta tërheqë ose ta revokojë vendimin e vet për shpalljen e këtij projektligji dhe ky vendim të merret këtu në këtë Kuvend.

Në anën tjetër ne kemi shumë raste edhe në rregullore, urdhëresa të Qeverisë etj, edhe ministrat i kanë miratuar këtu në Kuvend pa i lexuar fare

Kërkesa e dytë imja është ju lutem kryeministër dhe ju ministra të nderuar të mos veni nënshkrimin pa e lexuar së paku tri herë dokumentet që ju vihen përpara. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Bajrush Xhemajli.

DEPUTETI BAJRUSH XHEMAILI – Ju faleminderit z. kryetar, përshëndetje z. kryeministër, ministra, kolegë deputetë.

Unë desha vetëm një çështje ta vë në pah këtu. Fakti që vetëm për këtë ligj është shkruar, do të thotë ju kanë bashkangjitur Përfaqësuesit Special disa faktorë relevantë skenës politike. Unë mendoj se kjo tregon të kundërtën e asaj që thotë kryeministri, jo vetëm si një vullnet i mirë për të shkuar dhe për të ndihmuar se aty nuk ka çka të ndihmohet, përkundrazi nuk është ndihmuar, por ka ndodhur e kundërtë, për shkak që është

prezentuar për diçka që faktikisht që i ju ka bërë amini një materie që është në kundërshtim me krejtë procedurat. Unë mendoj që kjo është bërë thjesht dhe mendoj që është shumë shumë transparente, se është bërë përfitime politike. Kryeministri sigurisht ka dashur të thotë se unë jam me këto kategori dhe faktikisht këtu ka edhe probleme morale në këtë rast, për shkak se kanë dashur që të përfitojnë të gjithë ata që kanë qenë prezentë, në kuriz të kategorive vërtetë që më së pakti duhet të përfitohet.

Për mua kjo ka qenë e rëndë. Unë nuk e kam marrë tragjike se Peterseni e ka bërë, tani ka shkuar në Nju Jork, pse ka shkuar në Nju Jork ne jemi kompetent, mendoj këtu edhe duhet ta bëjmë, por nëse nuk e bëjmë edhe ne do të thotë po duam edhe ne diçka pak jo bash kthjellët do gjëra t'i shtyjmë përpresa, se ne mund ta bëjmë këte, ta tërheqim ligjin dhe Peterseni e ka çka ka bërë e bëjmë me një rrethanë më të mirë. Mendoj se duhet ta bëjmë këtë. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA –Ju faleminderit! Fjalën e ka deputetja Nekibe Kelmendi.

DEPUTETJA NEKIBE KELMENDI – Ju faleminderit z. kryetari nderuari z. kryeministër, ju falënderoj për gatishmërinë tuaj që të vini në interpelancë lidhur me çështjen që është ngritur nga PDK-ja, nuk kemi arsyë të mos u besojmë fjalëve tuaja se ky ligj ka shkuar në Nju Jork dhe se pritet që atje të jepet mendimi përfundimtar përkitazi me të. Mirëpo duhet ditur se nëse Nju Jorku përsëri e mban në fuqi ligjin të atillë që e kanë ndryshuar Përfaqësuesi Special, ne si Parlament, përkatësisht Qeveria, mund të iniciojmë ndryshimin e atij ligji, në mënyrë që megjithatë t'i heqim ato dispozita të cilat u shkaktojnë shqetësimë familjeve të dëshmorëve për lirinë e Kosovës, prandaj desha të them edhe diçka se nuk duhet t'i vishet Parlamentit të Kosovës që i shpall ligjet.

Dihet sipas Kornizës Kushtetuese kush i shpall ligjet. Ligjet i shpall Përfaqësuesi Special. Përpresa në legjislaturen e kaluar ka ekzistuar një panel i cili pas miratimit të ligjeve në Parlamentin e Kosovës, nëse ka pasur nga Zyra Ligjore e Përfaqësuesit Special ndonjë vërejtje, apo ndonjë mospajtim me ndonjë dispozitë ligjore, atëherë ai ka bërë shkresën dhe ka iniciuar vlerësimin e dispozitave në mënyrë që paneli të jepte mendimin e vet dhe për atë mendim të panelit është vendosur në Parlament përsëri. Nuk e di nëse tash funksionon ai Parlament, por e them me përgjegjësi të plotë se Zyra Ligjore e UNMIK-ut nuk është aspak kooperative dhe nuk është aspak transparente në punën e saj sa i përket përgatitjes teknike apo përgatitjeve të tjera për shpalljen e ligjit nga ana e Përfaqësuesi Special.

Sikur që nuk është fare kooperative me komisionet funksionale në fazat e shqyrimit të ligjeve dhe të amendamentimit të tyre. Prandaj nuk mund t'ia mveshim përgjegjësinë kryeministrit për një ligj të cilin e ndryshon Zyra Ligjore e UNMIK-ut, dhe e nënshkruan Peterseni si akt të shpalljes së tij, por ne kemi mundësi që ,megjithatë ,pas shpalljes së atij ligji menjëherë t'i iniciojmë procedurën e ndryshimit të tij në mënyrë që ligji ta marrë atë formë dhe përbajtjen që ia ka dhënë Parlamenti Ju faleminderit

KRYETARI KOLË BERISHA –Ju faleminderit! Deputeti i fundit që është paraqitur për diskutim është Kamber Kamberi.

DEPUTETI KAMBER KAMBERI. - Ju faleminderit z. kryetar. Edhe unë do të jem shumë i shkurtër, meqenëse ky ligj konsiderohet ndër ligjet më të ndjeshme ku bëhet kategorizimi nga pasojat e luftës.

Unë kërkoi -që është mendimi i përgjithshëm- se ky ligj duhet të mbetet ashtu i pandryshueshëm si është miratuar në Parlament, mirëpo shfaq mendimin se këto kategorizime duhet të rishqyrtohen apo të rivlerësohen, sepse në mesin e viktimate ose të martirëve të luftës, ka veprimtarë, pjesëtarë dhe luftëtarë të UÇK-së që kanë qenë të zhdukur gjatë periudhës së luftës dhe në ndërkohë pas tri katër apo edhe pesë vjetëve janë gjendur dhe tash mbeten në kategorizimin e viktimate apo të martirëve të luftës.

Mendoj se në një rishqyrtim dhe në një rivlerësim tjetër do të dalin edhe shumë dëshmorë apo edhe heronj. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA –Ju faleminderit! Diskutimi rreth kësaj pike përfundon dhe mund të kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës. Mendova se e pyeta a ka diçka të thotë.Urdhëroni z. Krasniqi. Keni pesë minuta në dispozicion.

DEPUTETI JAKUP KRASNIQI – Z. kryeministër, sinqerisht më vjen keq që keni gabuar, ose ju kanë shtyrë të gaboni, më vjen mirë që keni ardhur në Kuvend se ministrat e kabinetit tuaj për gjëra të tillë nuk kanë pranuar të vinin. Dua t'i them dy tri përgjigje, thuani se është e pamoralshme të fitohet politikisht, e saktë qind për qind, por është e pamundshme të bëhen mashtime publike dhe se mashtimi është vepër penale, sipas ligjit penal, dhe mashtimet zakonisht bëhen për përsitimet politike. Z. kryeministër, ju me simulimin se gjëja po e nënshkruani Ligjin keni bërë përfitime politike, a është kjo e ndershme, sigurisht që jo, a nuk e keni bërë për fitime politike për mashtrim të Opinionit dhe në fund çka e sa i ndihmuat kategoritë e dala nga lufta çlirimtare me atë simulim që bëtë?. Keqardhja është për t'u vlerësuar edhe grupi I PDK-së e vlerëson këtë .Ajo është garanci që nuk do të përsëriten simulimet në të ardhmen, që mund të jenë me pasoja edhe më të rënda sa simulimi për nënshkrimin e një ligji.

Z. kryeministër Grupi Parlamentar i PDK-së nuk ka ardhur në Parlament t'i besojë askujt blanko, as juve ,por pa marrë parasysh shkallën e besueshmërisë që e kemi te ju. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA –Ju faleminderit! Konstatoj se diskutimi rreth kësaj pike është shterë. Kalojmë në pikën 10 të rendit të ditës.

10. Shqyrtimi i propozimit për caktimin e kushteve dhe të kritereve për zgjedhjen e Avokatit të Popullit të Kosovës

Në pajtim me nenin 6 të Rregullores së UNMIK-ut dhe me institucionin e Avokatit të Popullit të Kosovës, në Kosovë, Kuvendi miraton procedurat për emërimin e Avokatit të Popullit, të zëvendësit kryesor dhe për zëvendësit e Avokatit të Popullit. Propozimin e rregullave procedurale e ka bërë komisioni për çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese.

Arsyetimin e propozimit do ta paraqet z. Hydajet Hyseni ,kryetar i komisionit.Nuk është këtu. **Nënkryetari z. Sadudin Berisha.**

DEPUTETI SADUDIN BERISHA – I nderuari kryetar, siç jeni të informuar me kohë se me rregulloren në fuqi për Avokatin e Popullit të nënshkuar nga administratori ndërkombëtar Petersen, parashihet detyrimi për zgjedhjen e Avokatit të Popullit, të zëvendësit të tij kryesor dhe të tre zënvedësve të tjerë, sipas rregullave të përcaktuara në rregulloren në fuqi për Avokatin e Popullit.

Në bashkëpunim me shefin e Zyrës së OSBE-së dhe me Komisioni për Legjislacion e në koordinim me Kryesinë e Kuvendit të Kosovës, ka filluar procedura për procedim për zgjedhjen e Avokatit të Popullit të zëvendësit kryesorë si kompetencë e Kuvendit që bëhet nëpërmjet kryesisë dhe Komisionit për Legjislacion ,i autorizuar nga Kryesia përgatitjen e procedurave që formalisht do të duhej të miratoheshin në Kuvendin e Kosovës.

Në takimin e djeshëm të Komisionit për Legjislacion, Kornizë Kushtetuese, janë miratuar rregullat e procedurës për emërimin e Avokatit të Popullit, përkatësisht zgjedhjen e tij, të zëvendësit kryesor të tij dhe zëvendësve të tjerë të Avokatit të Popullit dhe janë paraparë një numër rregullash procedurale .që gjithsejtë janë 15 rregulla procedurale. Pas miratimit të këtyre rregullave procedurale parashihet dinamikë dhe procedura që duhet t'u nënshtronë edhe Kryesia edhe Komisioni për Legjislacion për nominimin e kandidatëve të mundshëm për Avokat të Popullit dhe për zëvendësin kryesor.Miratimi i rregullave procedurale është bërë në harroi të plotë në Komision dhe në bashkëpunim me përfaqësuesin e OSBES-ë .Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA –Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Ramandan Kelmendi në emër të LDK-së,

DEPUTETI RAMANDAN KELMENDI – I nderuari kryetar, ministra të nderaur ,kolegë deputetë.Vlerësoj se duhet dhënë një sqarim se në mungesë të Ligjit për Avokatin e Popullit dhe për nevoja të tjera të mëdha për emërimin e tij është paraqitur arsyeshmëria e miratimit të Rregullores për zgjedhjen dhe emërimin e avokatit të popullit ,të zëvendësit të parë dhe të zëvendësve të tjerë.

Megjithëkëtë unë mendoj se ka munguar procedura paraprake e shqyrtimit të kësaj rregulloreje dhe lidhur me këtë do t'i kisha paraqitur vetëm katër vërejtje kryesore ,që vërtet nuk di si të përmirësohen, por megjithatë në këtë rregullore dhe procedurë përcaktimi i një rrathi të ngushtë paraprakisht eleminon cilësinë, do të ishte mirë që në intervistë të ftohen të gjithë kandidatët e interesuar për këtë post, se përndryshe vlerat dhe kualitetet profesionale në shumë raste të tilla po eliminohen apo paraprakisht po përcaktohen individët.

2.Nuk është përcaktuar struktura profesionalë e komisionit të intervistës ,gjegjësisht si quhet paneli në rastet konkret të intervistës.

3. Nuk është lënë mundësia që kandidatët e pakënaqur të ankohen dhe nuk është përcaktuar organi në të cilin do ta ushtrohej ankesa dhe e fundit që vërtet është ndoshta për mua më përbajtjesore është se zëvendësi i parë dhe zëvendësit e tjerë të Avokatit të Popullit duhet të zgjedhen patjetër në të njëjtën mënyrë si avokati për të pasur cilësi më të mirë dhe jo për t'u lënë mundësia që është alternativë që Avokati i Popullit të bëjë propozimin apo t'i zgjedhë vetë. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA –Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Nazim Jashari

DEPUTETI NAZIM JASHARI – I nderuar z. kryetar, i nderuar z. kryeministër, të nderuar ministra, kolegë deputetë. Më duhet të shpreh keqardhjen time që ky Kuvend shpeshherë po gjendet në cajnot një kohë të ngushtë, për një shpejtësi shumë të madhe kohore t'i kryejë punët që ka pasur kohë mjaft për t'i analizuar dhe shoshitur dhe trajtuar gjithanshmërisht edhe në një mënyrë ma komode, do të thosha.

Ne e dimë mirë kur ka shkuar Marek Aton Novicki nga Kosova , se Kosova është me ushtrues të detyrës të Avokatit të Popullit edhe të vjen puna tash për tri ditë që Kryesia t'ia kalojë Komisionit, komisioni dje , urgjentisht e trajtoi këtë rregullativë procedurale, që tek sot në mëngjes në kutitë e tyre postale ta gjejnë propozimin procedural për zgjedhjen e Avokatit të Popullit. Kjo urgjencë është krejtësisht e pajustifikueshme, mendoj se kohë ka pasur mjaft ,se ku duhet drejtuar gishti i fajtorit nuk e di, por mendoj se Kuvendi në këtë rast nuk është fajtor, ato instancat të cilat kanë pasur përgjegjësinë deri tani të emërimit të Avokatit të Popullit.

Mendoj se si grup parlamentar mund të them se procedurat e miratuara janë procedura të mira, nuk janë prefektë, janë të mira janë demokratike, mendoj se kandidatët të cilët do të enominohen i kanë në kuadër të kësaj procedure i kanë mundësit e tyre të garantuara të mbrojtjes së interesave të tyre dhe në aspektin e përzgjedhjes s besoj shumë se Kuvendi do ta përzgjedhë njeriu më të mirë në këtë moment për ushtrimin e kësaj detyre. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA –Ju faleminderit! MË parë se ta fajësojë dikën kisha me pranuar fajin për veti, por me kusht që ta aprovojmë këtë. Materialin e keni marrë dhe e keni parakushtet, mund të marrim vendim për këto kushte që të shpallet konkursi për

kandidatin Ombduspersoñin, ndërkohë paraqitet për fjalë kryetari i komisionit për legjislacion z. Hyseni

DEPUTETI HYDAJET HYSENI – Ju faleminderit z. kryetar, unë desha vetëm në vazhdimesi të asaj që u tha me shumë kompetencë nga z. kryetarit të Komisionit, vetëm të sqarojë se, kjo rregullore, dhe kjo procedurë, në një mënyrë është e bartur dhe e imponuar nga rregullorja me të cilën funksionon institucion i Ombuds personit.

Ne jemi në procesin e transferim të kompetencave në këtë fushë dhe kjo është faza përfundimtare e këtij procesi. Kemi punuar bashkërisht me institucionin e Ombudspersonit dhe me OSBE-në departamentin për sundim të ligjit dhe të drejtat e njeriut, dhe me këtë rast dua të shprehë mirënjojen edhe për institucionin e Ombuds personit edhe për ata që kanë punuar përpara edhe për ata që vazhdojnë punën sot.

Është bërë një punë e mirë në institucionin e avokatit të popullit, ta them saktë dhe është bërë një punë e mirë e OSBE-së në përgatitjen edhe të infrastrukturës ligjore për bartjen e këtij procesi.

Prandaj edhe rregullorja është në masë të madhe kontribut i përbashkët i ekspertëve edhe të komisionit tonë, edhe I anëtarëve të komisionit, por edhe i partnerëve tanë në institucionin e avokatëve të popullit dhe në Organizatën për Siguri dhe Bashkim Evropian në Prishtinë, sepse ne punojmë në ligjin për avokatin e popullit dhe mendoj që ai do të jetë rasti për t'i bërë përsosjet e nevojshme.

Sa i përket ankesës ne nuk e kemi futur për arsyen e thjeshtë, sepse kjo është rregulluar me akte të tjera ligjore, me ligje të tjera dhe nuk ka asnjë pengesë të shfrytëzohet e drejta e kandidatit për të ndjekur procedurën e mëtejshme.

Megjithatë, Kuvendi mund të bëjë ndonjë ndryshim. Gjithashtu lidhur me zëvendësit e Avokatit të Popullit, nuk mund të bëjmë ndryshime, siç u propozuan, sepse rregullorja ka paraparë dy kategori të zëvendësve, zëvendësin kryesor, i cili zgjidhet me procedurë tjetër dhe tre zëvendës të tjerë që zgjidhen nga Kuvendi, por me rekomandim të avokatit të sa po zgjedhur do të thotë, tashmë të zgjedhur.

Kështu që, mendoj me gjithë respektin për vërejtjen e kolegut, se duhet ta shikojë për më vonë në procedurën e mëtejshme. Unë prandaj do të shfrytëzojë rastin që duke i falenderuar të gjithë që kanë kontribuar në këtë dokument, duke respektuar edhe vërejtjet që u bënë, po punojmë në një kontekst kohor që na bën ndonjëherë të ngutemi dhe nuk shoh gjë të keqe që edhe nëse na shpëton ndonjë shkelje në funksion të përshpejtimit të procesi, kërkoi nga Kuvendi që të ketë mirëkuptim edhe për lëshimet eventuale dhe ta përkrahë rregulloren si të tillë. Ju faleminderit z. kryetar.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Pasi nuk ka të interesuar për diskutim më tutje e hedhim në votim, rregullat procedurale për zgjidhjen e Avokatit të Popullit. Lus regjinë që të përgatitet për votim, Votojmë tash.

Në sallë janë 77 deputetë

Për..... 68
Kundër..... 5.

Miratohet propozimi i rregullave procedurale për Avokatin e Popullit.

Kalojmë në pikën 11 të rendit të ditës

11. Pyetjet e deputetëve për Qeverinë

Ju njoftoj se në pajtim me rregullen 26.1. të Rregullores së punës të Kuvendit, koha për pyetjet e deputetëve për Qeverinë është e kufizuar gjithsej 50 minuta.

Kemi këto pyetje nga deputeti Ferid Agani, që i drejtohet ministrit Shatri.

Konform rregullës 26.2 deputetët kanë të nga 1 minutë për pyetje, përgjigja e ministrit ka afat 3 minuta, për pyetje plotësuese 1 minutë dhe përgjigjeje plotësuese 2 minuta.

DEPUTETI FERID AGANI- Ju faleminderit z. kryetar, të nderuar kolegë deputetë i nderuari z. kryeministër. Fillimisht dëshiroj që jashtë atij një minuti për pyetje që e kam ta përgëzoj këtë Kuvend, për fitoren e rëndësishme në përpjekjet për përparimin e proceseve demokratike në Kuvendin e Kosovës, në futjen e kësaj pike të rregullt në rendin të rendit të ditës dhe kam nderin që jam deputeti i parë që do ta fillojë këtë praktikë të re parlamentare për Kuvendin tonë. Në këtë mënyrë si është organizuar dhe është paraqitur sot dhe uroj që dita e sotme të shënojë një fillim të mbarë në këtë drejtim.

Është evidente se sot nuk e kemi prezent ministrin të cilin ia kam dërguar me shkrim pyetjen time parlamentare, po shpresoj që z. kryeministër do të jetë në gjendje të më përgjigjet për pyetjet.

Bëhet fjalë për një çështje ,për të cilën z. kryeministër ishte i njoftuar në muajin mars në fillim të mandatit të tij konkretisht, për çështjen e pagesës së kujdestarive për punëtorët shëndetësorë, mospagesa me muaj të tërë për punën e kujdestarisë ishte shkak i pakënaqësisë së madhe të punëtorëve shëndetësorë dhe i grevave të tyre të përsëritura.

Në bazë të nenit 27, paragrafi 3 të Ligjit për shëndetësi kujdesi shëndetësor sigurohet gjatë 24 orëve pa ndërprerje, duke organizuar punën me ndërresa në sistemin e kujdestarisë. Ndodh që të obliguarit sipas ligjit t'i përgjigjen kërkesës së drejtuesit të institucionit shëndetësor për kujdestari gjatë 24 orëve, punëtorët shëndetësorë nuk kompensohen nga burimi i qëndrueshëm financiar, nga kategoria e pagave dhe mëditjeve të buxhetit të Ministrisë së Shëndetësisë , por varësisht nga shuma e mjeteve të mbledhura nga bashkë pagesat e shfrytëzuesve të shërbimeve shëndetësore. Pyetja z. kryeministër është kjo.

A do të sigurohen mjetet financiare për pagesën e punës së obliguar me ligj të punëtorëve shëndetësorë, gjatë kujdestarisë, në kategorinë e pagave dhe të mëditjeve të buxhetit të Ministrisë së Shëndetësisë për vitin 2007? Ju faleminderit?

KRYETARI KOLË BERISHA –Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Fehmi Mujota. Më falni përgjigjuni pyetjes që ka bërë z. Agani.

Urdhëroni zëvendësministri Brajshori –

ZËVENDËSMINISTRI BEHXHET BRAJSHORI – I nderuari z. kryetar, kryeministër, të nderuar ministra, kolegë deputetë. Edhe pse pyetja i është adresuar ministrit, unë nuk kam autorizim prej ministrit të përgjigjem, por vetëm dua të them një procedurë që kemi zhvilluar tash me Ministrinë e Shëndetësisë, se mendoj që me të plotësohet ky vakum. Ne kemi arritur të nënshkruajmë memorandumin e mirëkuptimit për të siguruar burime financiare për punën shtesë që ka të bëjë me punën pas orarit, më kohëzgjatjen e tjera. Për disa kategori nuk do të hy në detale, sepse të them të drejtën, s'e kam paraparë ta kem, por mendoj se ashtu si është pajtuar edhe Ministria e Shëndetësisë, nëse sigurohen ato të hyra, do të ketë mundësi të kompensohet puna shtesë për ata punëtorët që do të kenë kohëzgjatje të punës dhe do t'u sigurohet qëndrueshmëri financiare për këto kategori. Ky memorandum i mirëkuptimit është nënshkruar para një jave ose 10 ditësh ndërmjet dy ministrave, të Ministrisë së Shëndetësisë, dhe të Ministrisë së Financave. Besoj se mund t'i implementohet, natyrisht ne duhet ta përcjellim mundësinë që nëse nuk plotësohen kërkasat e një qëndrueshmërie të financimit, do të shikohen edhe modelet e tjera që kjo kategori të jetë e mbuluar.

Memorandumi është nënshkruar, kurse ne të përcjellim realizimin e tij Besoj se edhe kolegu Ferid është i kënaqur në këtë fazë dhe do ta ndjekum punën e kësaj kategorie.

KRYETARI KOLË BERISHA –Ju faleminderit! Deputeti Alush Gashi e ka një vërejtje, po më duket.

DEPUTETI ALUSH GASHI – I nderuari z. kryetar. Çështja e pyetjeve të deputetëve për Qeverinë është mekanizmem I rëndësishëm i mbikëqyrjes parlamentare të punës së Qeverisë. Andaj është e pakuptimtë që këtu të debatohet pa prani të ministrave aktualë, përveç nëse kryeministri e merr obligimin që t'u përgjigjet pyetjeve në vend të tyre. Ne jemi dekluaruar si shumicë që do të jemi shumicë e përgjegjshme, andaj insistojmë që për pyetjet e bëra ministrat të jenë këtu. Ne nuk kemi korresponcencë dhe postë në Kuvend për këto çështje, andaj ju lutem- nëse është fjala për ministrin, ai duhet të jetë këtu, qoftë ajo përgjegjëje me shkrim apo me gojë, përveç nëse nuk është vendim i Qeverisë që kryeministri të përgjigjet në emër të tyre.

Kërkoj sqarim z. kryetar.

KRYETARI KOLË BERISHA –Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Sabri Hamiti.

DEPUTETI SABRI HAMITI – Unë nuk do të jap sqarim, sepse nuk kam çka të sqaroj, Alushi në princip ka të drejtë edhe ashtë, sepse nuk mund të shتروhet pyetja po të mos jetë personi këtu, nuk ka dialog pa dy veta, d.m.th. është monolog, po rikujtojë që këtë rregullore të cilën e kemi aprovuar të plotësuar para një seance tjetër, e le mundësinë, nëse deputeti do ta shtronë pyetjen e shtron dhe brenda dy mbledhjeve, ministri është i detyruar, nëse nuk është atë ditë, të përgjigjet, por është i detyruar të vijë, nëse jo arkivohet edhe del në byletin. Kështu thotë rregulla jonë që e kemi aprovuar vetë. Çka do të thotë kjo, sepse është dita e parë dhe normalisht është mirë që të sqarohen sendet, d.m.th. deputetët sot i kanë parashtruar 48 orë para kësaj dite pyetjet. Kanë të drejtë t'i lexojnë pyetjet sot, në qoftë se edhe nuk e kanë ministrin e resorit këtu, por nuk mund t'i marrin përgjigjet nëse ata nuk janë këtu, edhe pse s'janë, mund t'i marrin përgjigjet në mbledhjen tjetër. Sipas Rregullores sonë, sepse nuk është shumë lehtë për 48 orë t'i mbledhësh ministrat tanë në Parlamentin tonë, se nganjëherë nuk gjenden në Prishtinë fare. Me një fjalë nuk po e arsyetoj asken, por po tregoj evidenca reale.

Pyetjet mund të parashtronë që të jenë sa më konkrete, për njerëzit që janë këtu. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Deputeti Fehmi Mujota e ka një pyetje për kryeministrin Çeku.

DEPUTETI FEHMI MUJOTA – Ju faleminderit. Z. Kryeministër, për një kohë të gjatë në Shërbimin Civil të Kosovës nuk zbatohet Rregullorja 2001/19 dhe 2001/36 dhe drejtëpërsëdrejti i prek çështjet që kanë të bëjnë me Këshillin e Emërimeve të Larta Publike.

Ju jeni trashëgues i një varg shkeljesh të tillë, dhe se në vend që t'i përmirësonit këto shkelje, vazduhet edhe më tutje me po këso sshkeljesh. Dhe në Kosovë aktualisht kemi ushtrues detyrash të sekretarëve permanentë,

Por nuk kemi sekretar permanent. Në raste të caktuara kemi shkelje të shumëfishta dhe me motive të ndryshme, prandaj fjalë e juaj në Parlamentin e Kosovës, se do t'i ktheni funksionimin dhe sundimin e ligjit, ishte mjaft kurajuese. Pyetja është shumë konkrete.

Çfarë keni bërë deri më tani për evitim e shkeljeve ligjore që janë bërë në rastin e emërimeve dhe të shkarkimeve zyrtarëve të lartë të Shërbimit Civil me theks të veçantë të sekretarëve të pérhershëm dhe të shefave ekzekutive?

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Z. kryeministër e keni fjalën.

KRYEMINISTRI AGIM ÇEKU – Ju faleminderit i nderuari deputet Fehmi. Z. kryetar, unë para se t'i përgjigjem kësaj pyetjeje, dua ta përgëzoj Kuvendin e Kosovës, ju personalisht, kryetarin dhe Kryesinë e Kuvendit që i ka futur në praktikë këto forma komunikimi. Mendoj se edhe pse jeta jonë në Qeveri do të jetë shumë më e vështirë me këtë punë po ajo çka është me rëndësi rritet përgjegjësia, rritet transparenca e punës së Qeverisë dhe këtë unë e përshëndes edhe një herë ju përgëzoj për vendosjen e këtyre praktikave.

Shpreh gatishmërinë dhe keqardhjen për mungesën e disa ministrave, por herën tjetër shpreh gatishmërinë time se gjithë kabinetit ministrit do të jetë prezentë dhe t'i përgjigjet çdo pyetje që ju të nderuar deputetë e keni.

Sa i përket kësaj çështje të Këshillit për Emërimë të larta publike, unë dua ta pranoj që kjo ka qenë një ndër mekanizmat që ka qenë jo edhe aq efektiv në punën e Qeverisë, kështu që me të vërtetë iu kam qasur me seriozitet, të duhur dhe që 6 vjet ekziston ky këshill dhe deri më tash nuk ka pasur terma të referencës dhe nuk ka pasur asnjë rregullore, me të cilën rregullohen funksionimi, vendimeve që merren e tjera, tanë hartohen, kurse në mbledhjen e ardhshme, ne do t'i miratojmë rregullat e punës, ose Rregulloren e punës të Këshillit për emërimë të larta.

Gjithashtu deri më tash Këshilli është udhëhequr nga kryeministri, por sekretariati i Këshillit, një organ shumë i rëndësishëm i tij ka qenë i vendosur në Ministrinë e Shërbimeve Publike, d.m.th. jashtë kompetencave, përgjegjësisë ose mbikëqyrjes së kryeministrit dhe me një vendim të veçantë, propozim tim dhe mendim e këshillit ky sekretariat ka kaluar në zyrën time dhe praktikisht në pronësinë, udhëheqjen, mbikëqyrjen do ta ketë kryeministri tanë në këtë drejtim.

Këto janë disa masa organizative që i kemi marrë për ta bërë më efikas këtë mekanizëm shumë të rëndësishëm dhe shumë të ndjeshëm. Ne kemi përshpejtuar mbledhjet e këtij këshilli. Po thuaj se dy herë deri tri herë në muaj takohemi, nuk i rishqyrtojë vendimet e marra ma herët, nuk është kompetencë që t'i kthehem vendimit që janë marrë nga paraardhësi im apo nga paraardhësi tjerë tjerë, i shqyrtojmë ankesat d.m.th. të cilat vinë dhe vendosen në rend të ditës, formohen grupe të punës që i shqyrtojmë dhe propozojmë agjendë për takimet e ardhshme.

Kështu që po them, kemi marrë masa që Këshilli të jetë më efektiv, puna të jetë më transparente dhe në përputhshmëri të plotë me ligjin. Nuk do t'i kisha komentuar vendimet e mëhershme a janë bërë shkelje ligjore apo jo dhe nuk i rishqyrtojmë vendimet e marra më parë, por vetëm ato që vijnë në agjendë dhe mund të them se është e vërtetë që ka ushtrues detyre të këshilltarëve.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Vetëm një sqarim. Praktikat që po I zbatojmë për herë të parë këtu i ka propozuar Kryesia e Kuvendit, por i ka aprovuar Parlamenti i Kosovës, jo Kryesia as kryetari, prandaj shkojmë më tutje.

DEPUTETI FEHMI MUJOTA – Ju faleminderit, do të përpinqem që racionalisht ta shfrytëzojë kohën prej 1 minuti për të bërë një pyetje plotësuese.

Z. kryeministër në këtë çështje jo që po dëmtohen vetëm persona të caktuar, s'po i përmend me emra, në këto ministri që janë goditur, por po pësojnë edhe rrëth 70 mijë shërbyes civilë në Kosovë. Kjo praktikë duhet të ndërpritet urgjentisht, në të kundërtën do të bëjmë një praktikë të tillë që gjithmonë të kemi një padallueshmëri të qartë ndër stafet politike dhe ndër stafet të shërbyesve civilë, në fakt sekretarët permanentë dhe

shefat ekzekutivë janë punëtorë të shërbimit civil dhe nuk janë staf politik, në të kundërtën duhet të marrim masa të tjera, prandaj, ju keni nënshkruar disa nga vendimet në kohën prej se keni ardhur në rolin e kryeministrit, me shkak keni shkelur po të njëjtën gjë. Këto dy rregullore, në të dy rastet që u përmenden më lart, prandaj pyetja është kjo.

Kur do të përfundojë kjo çështje dhe kur ju do të merrni vendim për të kthyer ligjin në fuqi?

KRYETARI KOLË BERISHA –Ju faleminderit! Z. kryeministër urdhëroni.
Deputeti Gazmend Muhaxheri ka pyetje për z. kryeministër.

DEPUTETI GAZMEND MUHAXHERI – Pjetja ime z. kryeministër ka të bëjë me strategjinë dhe planin zhvillimor të Kosovës, që është në hartim e sipër.

Kush është duke hartuar strategjinë dhe planin zhvillimor të Kosovës, dhe mbi çfarë baze ligjore?

KRYEMINISTRI AGIM ÇEKU – Me 26 prill 2005 Qeveria e Kosovës e ka marrë një vendim të fillojë punën e hartimin e planit zhvillimor të Kosovës dhe qysh atëherë ka filluar. Në korrik të vitit 2005 janë formuar mekanizma të këtij procesi, është formuar një grup ndërministror ,që si komitet drejtues i këtij procesi, i bashkëkryesuar nga dy ministra, ai i Ekonomisë dhe Financave, dhe Ministri i Energjisë dhe I Minierave dhe disa ministra të tjera.

Në maj të këtij viti, duke përcjellë për së afërmë punën e këtij projekti ,kemi marrë disa masa shtesë, domethënë e kemi shpërbërë një grup operacional që ka qenë e qartë absolutisht puna e tij dhe e kemi krijuar një komitet drejtues të këtij procesi në krye të cilit është kryeministri. E kemi vlerësuar se nuk ka bashkëkryesues, nuk mund të ketë punë në qoftë se ka bashkëkryesues apo ndarje të përgjegjësive .E kemi krijuar një komitet drejtues, i cili drejtohet nga kryeministri,por anëtarët të këtij komiteti janë edhe disa ministra, ministri i Financave, i Energetikës dhe I Minierave, i Bujqësisë dhe in Zhvillimit Rural, i Planifikimit Hapësinor, ministri i Tregtisë dhe Industrisë, shefi i Shtyllës së Katër të UNMIK-ut, drejtori i DIFIDIT, USAID-it, I Bankës Botërore, i Fondit Monetar Ndërkombëtar, janë aktorët e sponsorues të këtij projekti dhe ndihmojnë. Ky këshillë merr ose trajton rezultatet e punës të këtij projekti. Projekti e ka sekretariatin e vet i përbërë nga 14 zyrtarë i udhëhequr nga profesor Ramadan Sadiku, i emëruar nga kryeministri qysh në korrik të vitit 2005, ky sekretariat e udhëheqë këtë projekt.

Projekti është tanë duke u hartuar, korniza makroekonomike, në të cilën janë duke punuar 17 ekspertë ,d.m.th. ekonomistë në mesin e tyre edhe dy eksperët ndërkombëtarë, korniza makroekonomike duhet të vijë para këtij këshilli drejtues deri në fund të këtij muaji ku do të diskutohet dhe aprovohet. Gjithashtu janë duke punuar 22 grupe punuese teknike të cilat janë duke hartuar plane zhvillimore të 22 sektorëve ekonomik.

Qëllimi është që ky plan zhvillimor të përfundojë deri më fund të vitit dhe të shërbejë ku do të definohen projektet, korniza makroekonomike një anë dhe projektet konkrete të sektorëve të ndryshëm ekonomik dhe të prezantohen në fillim të vitit pas statusit si një dokument, plan zhvillimor i Kosovës para donatorëve ndërkombëtarë në një konferencë të madhe të donatorëve. Mendoj që, projekti financohet nga shumë donatorë, nga Qeveria me 450 mijë €, por financohet edhe nga..... kështu që janë shumë faktorë relevantë të kyçur. Si ka zënë të shkoj procesi dua të them se do ta vlerësojmë kur të ballafaqohemi me punën e hartimit të kornizës makro ekonomike, kështu që në një mbledhje të ardhshme mud t'ju raportoj si ka shkuar procesi deri më tanë. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA –Ju faleminderit! Fjalën e ka z. Muhaxheri

DEPUTETI GAZMEND MUHAXHERI – Z. kryeministër, ju faleminderit përgjigje. Edhe në të ardhmen do të bëjë pyetje në këtë fushë, mirëpo për sot e kam edhe një pyetje shtesë, pyetja ime ka të bëjë me:

Çka e obligon Qeverinë e ardhshme d.m.th. kryeministrin e ardhshëm të Kosovës që t'I përbëhet kësaj strategjie që jeni duke hartuar ju tanë?

KRYETARI KOLË BERISHA –Ju faleminderit! Për pyetje janë paraqitur edhe deputeti Hydajet Hyseni i ka tri pyetje, por nuk janë ministrat prezentë të cilët u është drejtuar, deputetja Safete Hadergjonaj dhe deputeti Xhevati Bislimi dëshiroj t'i paraqiti sot këto pyetje. Urdhëroni z. Hyseni

DEPUTETI HYDAJET HYSENI – Ju faleminderit z. kryetar i nderuar kryeministër, të nderuar ministra, zonja dhe zotëri deputetë.

Unë me të vërtetë kam parashtruar një pyetje, dy të tjera janë pyetje që janë parashtruar një vit më parë e i kam riparashtruar, po t'I i kishim respektuar ndoshta do të isha i pari para deputetit Agani, kjo nuk llogaritet. Së pari unë i bashkëngjitëm kërkesës që ministrat të janë në seancën e pyetjeve, kurse i takon Kuvendit që ta harmonizojë edhe kohën e seancës së pyetjeve me Qeverinë, (me sa di është caktuar ora 2), prandaj më lejoni t'ju falënderoj kryetar, por këtë që thashë nuk bëjnë pjesë në kohën e paraparë për pyetje. Ju lutem të mos përfshihet edhe kjo që do të them më vonë. Nuk e drejton seancën regjia as teknika, por kryetari dhe kryesuesi, prandaj lexoni edhe dispozitën sipas së cilës në interes të punës së Kuvendit dhe mirëkuptimit të zgjatet koha, më lejoni që të lexoj dy të parat.

KRYETARI KOLË BERISHA –Ju faleminderit! Seanca drejtohet sipas Rregullorës të cilën e kemi miratuar së bashku këtu. Urdhëroni.

DEPUTETI HYDAJET HYSENI – Pyetja e parë ka të bëjë me çështjen e pasojave të tërmëtit, nuk po e shoh të arsyeshme të bëjë hyrje. Ky Kuvend ka vendosur që një shumë e caktuar (5 milion €) të ndahet për zbutjen e pasojave të tërmëtit para sa vitesh në

Gjilan. Ju e dini çka ka ndodhur, e tani ka pasur edhe informacione plotësuese zyrtare. Pjetja ime është kështu:

Në pajtim me rregullën 22 të Rregullores së Kuvendit i riparashtoj Qeverisë së Kosovës dhe Ministrisë së Pushtetit Lokal, këtë pyetje parlamentare.

Sa dhe si është shpenzuar mjetet e dedikuara për zbutjen e pasojave të tërmetit në komunën e Gjilanit, dhe çka ka ndërmarrë Qeveria, respektivisht ministria pushtetit lokal dhe Ministria e Financave lidhur me keqpërdorimet e konstatuara dhe lidhur me pengesat që i nxirren institucionit të Ombuds personit për hulumtimin e rasteve?

Pjetja e dytë, ka të bëjë me çështjen e refugjatëve dhe të zhvendosurve nga Presheva, Bujanovci, Medvegja dhe viset tjera e shtruar një vit më parë.

Çfarë është gjendja e refugjatëve dhe të zhvendosurve nga Presheva, Bujanovci, Medvegja dhe vendbanimeve tjera të vendlorës në Kosovë dhe çka ka bërë Qeveria dhe ministria përkatëse, ministria për kthim në këtë rast dhe komunitete për zgjidhjen e problemit të tyre.

Të nderuar deputetë, pyetja aktuale, për fat të keq aktuale, kanë mbetur edhe këto të mëparshmet edhe pas këtij viti duke pasur parasysh faktin se çdo i treti banor i Kosovës jeton jashtë në statuse të ndryshme duke I pasur parasysh rolin e pazakonshëm të mërgatës në të sotmen në Kosovë dhe kërkesën e vazhdueshme të mërgimtarëve tanë për përkujdesje institucionale, shtroj këtë pyetje,

Çfarë kanë bërë Qeveria e Kosovës dhe Ministria përkatëse për zgjidhjen e problemeve të shumta dhe më të ndryshme, me të cilat përballen vijimimisht qytetarët e Kosovës që në cilësi të ndryshme statusore jetojnë ose punojnë në vende të ndryshme të botës?

Veçanërisht do të dëshiroja përgjigje në çështje që ndërlidhen me vështësitë që kanë ata me dokumente civile, çka u bë me revistën ë ka pasë nisur të dilte që përmendej disa herë në raportin e sekretarit përgjithshëm si sukses, pse u ndërprerë ajo? Pse nuk organizohen aktivitete kulturore, informatike, edukative, si më parë dhe çka bën Qeveria për përmirësimin e problemeve të mërgatës dhe për përbushjen e kërkesave të tyre të shumta?

KRYETARI KOLË BERISHA –Ju faleminderit! Deputetja Safete Hadergjonaj.

DEPUTETJA SAFETE HADERGJONAJ – Meqë nuk është ministri Shatri, ndoshta do të më përgjigjet edhe kryeministri, nëse jo unë po e bëjë sipas rregullores pyetjen,

Mungesa e transparencës ndaj tatimpaguesve nga administrata tatimore e Kosovës, ka lënë hapësirë për të dyshuar se aty ka keqmenaxhim dhe keqpërdorim të mjeteve.,

Shqetësues është ndikimi i politikës në administratën tatimore, ku po manifestohet - pasojë e kësaj po shfaqet pushteti interpretues i administratës tatimore ndaj bizneseve, por po pëson më së shumti buxheti i konsoliduar i Kosovës. Raporti i administratës nuk vjen në Kuvend, d.m.th. nuk ka transparencë ndaj Kuvendit dhe atëherë si mund të mendohet që ka transparencë ndaj qytetarëve. Kështu që keq menaxhimi dhe keq përdorimi i mjeteve janë dy brengë ttë mëdha të qytetarëve të Kosovës që cilët.....

KRYETARI KOLË BERISHA –Ju faleminderit! Ndryshimi që është bërë në Rregullore e keni vetëm 1 minutë të drejtë për pyetjeje.

DEPUTETJA SAFETE HADERGJONAJ- Pyetja ime është kjo,

Pse janë shkelur nenet 8.2 dhe neni 8.3 të Ligjit për administratën tatimore dhe procedurat nr. 2004/48 sipas të cilave Administrata tatimore e Kosovës është e obliguar t'i dorëzojë raport vjetor Kuvendit brenda 3 muajve për vitin kalendarik pas përfundimit të vitit kalendarik dhe ky raport nuk është dërguar në Kuvend?

KRYETARI KOLË BERISHA –Ju faleminderit! Deputeti Xhevati Bislimi, nuk është në sallë.

Deputetë të nderuar me kaq përfundon rendi i ditës për sot. Kemi pushim deri në orën 14, 50 minuta, ku do ta kemi në mesin tonë kryeministrin e Shqipërisë z. Sali Berisha.